



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
TË MBAJTUR MË 24.10.2017

TETOR
2017

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Komisioni për Legjislacion, z. Albulena Haxhiu

KRYETARJA: I nderuar zoti ministër Abelard Tahiri,
Në emër të Komisionit për Legjislacion, ju falënderoj për prezencën tuaj në Komisionin për Legjislacion, ku jeni të ftuar për të raportuar në lidhje me marrëveshjen për drejtësinë të vitit 2015.

Fillimisht do të doja një prezentim të gjithë rrjedhës së marrëveshjes për drejtësinë. Sigurisht që lidhet edhe marrëveshjen e prillit të vitit 2013.

Pastaj për të kaluar te diskutimi jonë mundësisht për brenda kohës deri në 15 minuta në qoftë se është nevoja edhe më shumë në qoftë se është nevoja.

Mirëpo para se të dal te fjala e juaj, vetëm 2-3 pyetje, përveç diskutimit a e vlerësoni që Marrëveshja për drejtësinë është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e aplikueshme.

Si ka shkuar procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë, domethënë në kohën kur është nënshkruar Marrëveshja për drejtësinë, ngjitur me të a ka pasur edhe një listë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët janë sjell nga Serbia për t'u emëruar pastaj në Kosovë, dhe çka do të ndodhë me aktgjykimet e lëshuara nga strukturat paralele.

Pra, këto janë disa nga pyetjet e mija, sigurisht që pas fjalës tuaj do të inkuadrohem sërish. Zoti ministër fjala është për ju.

MINISTRI ABELAR TAHIRI: Faleminderit!

E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të Komisionit,

Të nderuar gjithë ju të pranishëm në sall,

Ju faleminderit, për këtë mundësi që të jem sot këtu para jush të raport për implementimin e Marrëveshjes për drejtësi të nënshkruar në gusht të vitit 2015 në mes të dy kryeministrave.

Në fakt do të doja të filloja duke raportuar për suksesin e sotëm për dekretimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga komunitetet jo shumicë.

Presidenti i Republikës së Kosovës, sot ka dekretuar gjithsejtë 53 gjyqtarë dhe prokurorë nga komuniteti jo shumicë. Më saktësisht 40 gjyqtarë dhe 13 prokurorë për të gjitha gjykatat, pra nga Gjykata Themelore deri te Gjykata Supreme.

Dekretimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve është bërë në pajtim me propozimin e Këshillit Gjyqësorë të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe në pajtim të plotë me legjislacionin e Kosovës në fuqi.

Këshilli gjyqësorë i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës në pajtim me përgjegjësitë e tyre kushtetuese dhe ligjore e kanë konsideruar si veprim afirmativ dhënien e propozimeve për të

rritur numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga komunitetet jo shumicë, siç është përcaktuar me kushtetutën dhe me ligjet për mbrojtjen nga diskriminimi të cilën me marrëveshjen e arritur në Bruksel me datë 10 shkurt 2015 e cila është vazhdimësi e marrëveshjes së ratifikuar nga Kuvendin me Ligjin numër 04/L-199.

Marrëveshja e Brukselit për Drejtësi si derivat i marrëveshjes së vitit 2013 ka paraparë funksionim të plotë të gjykatave dhe prokurorisë në komunat në veri të vendit sipas ligjeve dhe kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kjo marrëveshje është rikonfirmuar më datën 31 gusht të vitit 2017, në takimin e dy presidentëve të Republikës së Kosovës si dhe të Republikës së Serbisë.

Si datë për zbatimin e kësaj marrëveshje ka qenë 17 tetori i vitit 2017. Mirëpo për çështje kryekëput teknike është shtyrë për sot pra implementimi i kësaj marrëveshje gjegjësisht dekretimi i këtyre gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Megjithatë, me qëllim që rendi dhe ligji në Kosovë të shtrihet në tërë territorin e Kosovës dhe që kushtetutshmëria të veproj në territorin e Kosovës dhe Kosova të konsolidoj integritetin juridik dhe ligjor në tërë territorin e vetë Presidenti Thaçi ka propozuar që si datë të dytë për zbatimin e marrëveshjes të jetë data 24 tetor, pra dita e sotme. Në kuadër të kësaj marrëveshje përveç 53 gjyqtarëve dhe prokurorëve është angazhuar edhe një staf shtesë prej 107 administratorëve të gjykatave, po flasim për gjykatat në veri. Kjo i ka hapur rrugë zgjidhjes së kryetarit të Gjykatës Themelore të veriut, gjykatave në veri të vendit. Konkursi për kryetar të Gjykatës Themelore të veriut skadon nesër, pra edhe nesër gjyqtarët e dekretuar sot nga Presidenti kanë mundësi të konkurrojnë për kryetar të gjykatave.

Më lejoni të theksoj se gjatë kësaj periudhe nga gushti deri më sot, institucionet e Republikës së Kosovës kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur kushtet teknike dhe funksionalizimin e gjykatave. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë dhënë kontributin e tyre të jashtëzakonshëm të rëndësishëm për krijimin e këtyre kushteve teknike dhe operationale. Duhet falënderuar në këtë rast edhe partnerët tanë Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, komisionin evropian si dhe EULEX-in që kanë qenë në koordinim të plotë me neve gjatë tërë këtij procesi. Prej se jam emëruar ministër i Drejtësisë këtë temë e kam trajtuar me seriozitet dhe përkushtim absolut. Kam kërkuar dhe kam mbajtur takime të rregullta javore me të gjithë akterët e sipër përmendur për të siguruar se çdo hap në implementimin e kësaj marrëveshje është duke u ndërmarrë dhe do të arrijë ta realizojë pra këtë që bëmë sot.

Të nderuar deputetë,

Konsideroj se është një koincidencë e mirë fakti që sot jam ftuar të raportoj para jush për zbatimin e kësaj marrëveshje, pikërisht në ditën kur edhe ajo filloi të zbatohet. Jam tejet i motivuar të them se nga sot shtrirja e sovranitetit në terma praktikë po ndodh në gjithë vendin. Tani e tutje qytetarët e Kosovës në tërë tërësinë territoriale të saj do të ballafaqohen me një sistem unik të drejtësisë. E kjo është një e arritur për sistemin e drejtësisë së Kosovës dhe është

një hap i madh drejt konsolidimit të plotë të integritetit juridik e shtetëror të Kosovës, si hap drejt shuarjes së plotë të institucioneve ilegale të Republikës së Serbisë që kanë vepruar brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Prandaj, ju përgëzoj edhe juve për këtë të arritur të sotme, ju falënderoj për këtë mundësi qysh në fillim të mandatit tim të raportoje pra për një sukses tejet të rëndësishëm. Kosova po hyn në përvjetorin e dhjetë të pavarësisë dhe fatkeqësisht u deshën 10 vjet që të arrijmë funksionalizimin e plotë të sistemit të drejtësisë edhe në atë pjesë të vendit të veprojnë gjykatat krahas prokurorëve dhe policëve tanë që tashmë i kemi andej.

Faleminderit unë jam i gatshëm për pyetjet e juaja.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në 2-3 pyetjet, të cilat i parashtrova nuk je përgjigj.

MINISTRI ABELART TAHIRI: Po, të vazhdoj unë. Unë konsideroj që këto marrëveshje janë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Një gjë e tillë ekziston mundësia që të dërgohen edhe në Kushtetutë jep vlerësim edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Kam qenë afër Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Kosovës gjatë tërë kësaj periudhe. Implementimi i kësaj marrëveshje është bërë nga këto dy institucione, i përgëzoj për angazhimin dhe punën e tyre si ministër i Drejtësisë kam ofruar përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës që në çfarëdo aspekti pa dashur të ndërhyjë në asnjë moment në rekrutimin e gjyqtarëve dhe stafit tjetër administrativ që është bërë që të mos ndërhyjmë në punën e tyre, mirëpo kemi dhënë mbështetje financiare, teknike në implementimin e kësaj marrëveshje.

Rekrutimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk ka ndodh me asnjë lloj liste, ka pas një konkurs që ka qenë i hapur. Ata gjyqtarë kanë konkurruar në bazë të këtyre rregullave që përcaktohen me ligje të Kosovës zyrtarë administrativ që kanë hy, janë po ashtu njerëz që kanë konkurruar në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës dhe ju siguroj për këtë se në asnjë rrethanë nuk ka pas kurrfarë liste që ka ardhur nga asnjë shtet tjetër, asnjë agjencion tjetër që të ndërhyjë deri te ky proces. Ka qenë një proces fer që ka qenë shumë mirë i organizuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Këto dy pyetjet, pyetja e tretë ishte për aktgjykimet, nuk do të ketë, domethënë unë ju siguroj edhe juve nuk do të njihet kurrfarë aktgjykimi që nuk ndërmerret prej gjykatave të Republikës së Kosovës. Ju sigurojmë dhe ju garantojmë për këtë, domethënë ne e kemi një jo marrëveshje, e kemi një bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Prokurorial edhe Këshillin Gjyqësor dhe nuk do të tolerojmë që të ketë kurrfarë aktgjykimi tjetër që s'është bërë mbi bazën e ligjeve ekzistuese të Kosovës.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Unë e di ndryshe po e dëshmoj këtu me fakte. Së pari në emër të Komisionit për Legjislacion ju falënderoj për raportin që bëtë për marrëveshjen për drejtësinë dhe sigurisht që dua të ndërlidhem me disa prej çështjeve ta zëmë kur thoni që kjo marrëveshje është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mua më intereson të di se në cilën prej neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës paragjykohet nacionaliteti i gjyqtarëve, domethënë në cilën prej këtyre neneve thuhet që gjyqtari apo kryetari i

gjykatës atje do të jetë serbë a po më tregon, sepse unë po flas zoti ministër të lutem, unë ty nuk të ndërpreva andaj, kërkoj që ta respektosh fjalën time pastaj nëse dëshiron mund ta marrësh fjalën edhe njëherë.

Ju thatë që ky proces është vonuar kryesisht për çështje teknike, por kështu nuk ka thënë zyra e presidentit për faktin se në kohën, në javën e kaluar kur ai priste gjyqtarët dhe prokurorët për t'i dekretuar komunikata e presidencës ka qenë arsyeja se pse s'janë dekretuar këta gjyqtarë dhe prokurorë. Janë për shkak të ndikimeve të Serbisë në gjithë këtë proces. Marrëveshja e 10 shkurtit e vitit 2015, unë e kam këtu përpara dhe kjo është versioni i marrëveshjes, shihini një letër A4, as nuk shkruan, jo është marrëveshje që është edhe në ueb faqe të Qeverisë.

Domethënë është një letër A4 e bardhë, nuk shkruan ndërmjet kujt dhe asgjë tjetër. ne konsiderojmë se është në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe sigurisht që kemi shprehur shqetësimet tona për faktin se krijon standarde të dyfishta dhe është një marrëveshje etnike pikërisht për faktin se përmendet ta zëmë serbë dhe përjashton komunitetet tjera. Sipas kësaj marrëveshje, zoti ministër, rezulton se Kosova tash e tutje do të ketë dy sisteme brenda sistemit të brendshëm. Një sistem i cili tenton që të sigurojë pjesëmarrje për të gjithë qytetarët në jetën institucionale dhe tjetri sistem i cili garanton pjesëmarrjen e vetëm një etnie, për shembull rasti i ngjashëm apo i juridizuar është edhe ai me Drejtorin Rajonal të Policisë për komunat e veriut siç thuhet, sepse edhe aty thuhet që është serbë dhe tani me marrëveshjen për drejtësinë ku parashikohen kuota etnike për pozita zyrtare sikurse që është rasti i kryetarit të Gjykatës Themelore për Mitrovicën i cili garantohet personave siç shkruan në marrëveshje të nacionalitetit serbë.

Kjo s'ka bazë Kushtetuese dhe as ligjore. Po ashtu, ju thatë që është në përputhje të plotë me ligjet e aplikueshme ta zëmë Ligji për gjykatat. Ligji për gjykatat parasheh vetëm një gjykatë të apelit për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe selia e Gjykatës së Apelit është në Prishtinë, në ndërkohë si vijimësi është edhe një divizion siç shkruan "divizion" në thonjëza të Gjykatës së Apelit që do të merret vetëm me rastet e serbëve dhe sigurisht që kjo është edhe në shpërputhje me Ligjin për gjykatat edhe në shpërputhje me Kushtetutën e Republikës.

Ju thatë që aktgjykimet e lëshuara nga strukturat paralele nuk do të njihen, nuk e di në qoftë se Këshilli Gjyqësor ju ka informuar njësoj, unë kam bërë përpjekje zyrtare që të siguroj në qoftë se qëndron ajo që e kam dëgjuar për faktin se kam kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që të më pajisë zyrtarisht, sepse këto dokumente nuk mund të fshihen me të gjitha dokumentet që lidhen me marrëveshjen për drejtësinë. Nuk kam arritur që të kem sukses në përpjekjen time për të siguruar dokumentet dhe siç më është thënë këtë e ka bërë të pamundur zonja Edita Tahiri e cila në atë kohë ishte ministre për Dialog ka kërkuar që asnjë dokument që lidhet me marrëveshjen mos ta nxjerrin as nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, e as nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Mirëpo, unë kam shfrytëzuar të drejtën tjetër dhe kam siguruar dokumente jo zyrtare, domethënë jo në rrugën zyrtare dhe këto dokumente janë skandaloze, zoti ministër, për faktin se këtu parashihet që do të njihen të gjitha vendimet e gjykatave paralele edhe për rastet civile, edhe për rastet administrative, edhe për rastet penale. Domethënë, unë kam këtë dokument këtu meqë ka

media e kam siguruar kështu siç e kam siguruar, domethënë dhe gjithashtu në këtë marrëveshje janë të bashkangjitura emrat e gjyqtarëve që delegacioni i Kosovës i ka marrë në Serbi.

Ja i kam këtu të gjithë emrat e gjyqtarëve që Serbia i ka servuar delegacionit të Kosovës ia ka dhënë në tavolinë të njëjtit sot janë emëruar dhe unë kam informacione, ndoshta janë shtuar edhe disa të tjerë, dhe unë kam informacione se teksti i betimit uroj që kjo të mos jetë e vërtetë, sepse këto të tjerat qëndrojnë nuk është bërë sikurse edhe me gjithë gjyqtarët dhe prokurorët tjerë. Po e them, teksti i betimit është “betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës si gjyqtarë i Republikës së Kosovës do t’i qëndroj besnik Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe do të ushtrij funksionin e gjyqtarit me nder, përgjegjësi dhe paanshmëri duke respektuar rregullat e etikës profesionale”, në qoftë se ky është teksti i betimit unë do të bëjë përpjekje që ta siguroj edhe dekretin, por edhe tekstin e betimit, sepse tekstet e betimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve mbesin aty, pra nuk publikohen dhe dekreti është thjeshtë domethënë emri dhe mbiemri dhe nuk përmend ndonjë simbol apo nuk përmend Republikën e Kosovës.

Në qoftë se ky proces kishte qenë proces i drejtë që ka për qëllim shtrirjen e sovranitetit në pjesën veriore të vendit tonë, atëherë pse ka nevojë që dokumentet e tilla të mbesin sekrete. Dhe, për mua është shqetësuese se si delegacioni i Kosovës ka pranuar që të njihen të gjitha aktgjykimet e strukturave paralele atje. Kjo është skandal jashtëzakonisht i madh, ky është cenim jashtëzakonisht i rëndë madje për këtë duhet të jep llogari dikush.

Merreni me mend zyrtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial nuk kanë guxuar që të më pajisin zyrtarisht me dokumentet, të cilat janë nënshkruar në Bruksel dhe sigurisht që kjo për ne si Lëvizje “Vetëvendosje” është e papranueshme, unë do të bëj përpjekje edhe emrat e gjyqtarëve sot që janë dekretuar t’i kemi, por edhe të prokurorëve, sepse për sa kohë kam siguruar emrat e gjyqtarëve kam dështuar që t’i gjej prokurorëve, sepse askush s’ka guxuar qoftë edhe në rrugën jo zyrtare që të mi sjell këtu.

Pra, zoti ministër është e padrejtë kjo që po theksoni ju për faktin se as nuk shpjegohet se në qoftë se këta gjyqtarë bëjnë shkelje të rëndë, kush i shkarkon, sepse nuk thuhet në asnjërën prej pikave a i shkarkon Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës madje për neve si “Vetëvendosje” është e papranueshme se si i keni marrë përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial në delegacion këto dy institucione që thuhet që janë të pavarura i keni marrë me një proces politik.

Këto janë qëndrimet e mija për momentin, por sigurisht po ta kaloj fjalën ty në qoftë se pajtohen edhe anëtarët e tjerë të komisionit, pastaj e marrin fjalën edhe anëtarët e komisionit pas fjalës tënde.

MINISTRI ABELART TAHIRI: Faleminderit!

Unë po të siguroj një gjë, që dekretimi i këtyre gjyqtarëve ka shkuar sipas ligjeve në fuqi që përcakton rekrutimin e një gjyqtari. Unë nuk i di këta emra që po i thua ti, këta njerëz që sot janë dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës kanë kaluar nëpër një proces, si gjyqtarët, si prokurorët domethënë formal duhet me qenë formal.

Edhe nuk e ka caktuar Vuçiqi e ka caktuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk e di për çfarë dokumente po flet, unë po të flas për procesin qysh janë rekrutua

gjqtarët dhe qysh janë rekrutuar prokurorët që janë në kuadër të këtij sistemi të Republikës së Kosovës. Kush i shkarkon këta prokurorë dhe këta gjyqtarë në rast se bëjnë shkelje, kjo çështje është e rregulluar me ligjet e Kosovës dhe në asnjë rrethanë nuk mund të rregullohet me një marrëveshje kush e shkarkon ose kush e largon një prokuror ose një gjyqtar. E kemi një zyre të prokurorit disiplinor i cili merret me këto çështje.

Unë po ju siguroj dhe nuk është mirë të dezinformohet opinionit mbase edhe ju jeni dezinformuar, nuk ka kurrfarë marrëveshje e cila bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk ka kurrfarë aktgjykimesh që do të implementohen në Republikën e Kosovës të ndërmarra që janë nga gjykatat tjera. Çdo aktvendim do të jetë, unë e kam parë dhe kam qenë afër këtij procesi prej momentit kur janë emëruar. Në çdo javë kam pas takime të rregullta, kam qenë shumë i interesuar të marr pjesë, të jem afër këtij procesi dhe të shoh çdo lëshim ose çdo parregullsi që mund të ndodh. Domethënë, procesi i shtyrjes ju e përmendët edhe deklarin e presidentit, unë nuk dua të komentoj as deklaratën e presidentit, as të juajin, unë po them që ky proces ka qenë i bazuar në ligjet e Kosovës dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të rekrutimit të tyre.

Edhe të zyrtarëve civil, edhe të administratorëve edhe ata janë bërë kryekëput bazuar mbi ligjet e Kosovës. Ata në momentin që do të bëjnë shkelje është Zyra e Prokurorit Disiplinor e cila do të merret me ato çështje. unë të siguroj për këtë dhe ne e kemi mundësinë të jemi nga afër dhe të shohim punën e tyre.

ALBULENA HAXHIU: Sigurisht që kam qëndrimet edhe të tjera, mirëpo po ju lë hapësirën edhe anëtarëve për të qenë korrekte, por Arbeni e ka kërkuar fjalën fillimisht, pastaj Sami Kurteshi, pastaj zoti Beqa.

ARBEN GASHI; Sami e di që “Vetëvendosja” doni që të flitni krejt po shkon pak me rend kjo punë. distribuohet edhe faleminderit Albulena që ma dhe fjalën, ministër mirë se ke ardhur.

Dashta të komentoj pak te dokumentet që zonja Haxhiu u prezantoi këtu, mendoj që është jashtëzakonisht e rëndë dhe e papranueshme që dokumentet zyrtare të prodhuara në një proces dialogu në Bruksel të mos jepen deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ju e dini që në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Kushtetutës së Kosovës, deputetët individualisht e aq më shumë edhe komisionet parlamentare apo kryetarët e komisioneve kanë të drejtë të pajisen me çdo lloj dokumenti që posedon Republika e Kosovës dhe që nuk konsiderohet ose nuk është protokolluar si dokument sekret shtetëror.

Pra, përderisa ai dokument që ju zonja Haxhiu e posedoni nuk është kualifikuar si dokument sekret shtetëror ju dhe secili deputetë i Kuvendit të Kosovës ka të drejtë ta posedojë. Për shembull, unë mendoj se duhet t'i drejtoheni në emër të komisionit zyrtarisht edhe Këshillit Prokurorial edhe Këshillit Gjyqësor që të ju pajisin me këtë lloj dokumentacionesh dhe nëse ata nuk e bëjnë atëherë ne duhet të marrim veprime tona si Kuvend i Kosovës.

Te çështja tjetër, zoti ministër, unë pata një kërkesë për ju ose më shumë një sqarim. Emërimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve sot dhe po ashtu, caktimi i administratorëve a reflekton përbërjen etnike të komunave për të cilat këta janë emëruar. Pra, a e reflekton përbërjen etnike? Sa janë të

etnive të tjera apo janë vetëm të një etnie këta prokurorët dhe gjyqtarët e emëruar. Dhe një kërkesë edhe zyrtare, por edhe miqësore të kisha lut që kur i referoheni këtyre komunave të mos i referoheni si veriu i Kosovës, por si veriu i vendit, sepse është terminologji jo kushtetuese dhe si e tillë të paktën në Kuvendin e Kosovës dhe nga zyrtarët të profilit të lartë siç jeni të mos përdoret, sepse është një terminologji gabim. Nuk ka veriu i Kosovës, veriu i vendit bëhet fjalë për tri komunat: Komuna e Mitrovicës veriore, dhe komunat tjera me radhë, të cilat ju mund t'i referoheni.

Është si kërkesë edhe miqësore edhe zyrtare si të doni trajtoni, te sqarimi kisha lut nëse .. unë nuk e kam këtë informacion, nuk e di se çfarë etnie i përkasin ose çfarë etnie janë deklaruar se ata mund të deklarohen çka të duan. Gjyqtarët dhe prokurorët e emëruar dhe po ashtu 107 zyrtarë apo administrator, të cilët janë emëruar. Dhe në këtë analizë që ju normalisht e keni bërë si ministër sa reflektohet përbërja etnike e këtyre komunave ku këta janë emëruar që të kryejnë detyrat e tyre. Faleminderit!

ALBULENA HAXHIU: Vetëm po e lexoj për me qenë edhe e saktë me mediat çka shkruan në këtë dokument që kam siguruar që është vazhdimësi e marrëveshjes për drejtësi veç është arrit në 2016, domethënë një vit pas.

Aktgjykimet e lëshuara nga gjykatat në Serbi deri më 15 korrik 2013 që kanë të bëjnë me aktgjykimet apo vendimet nga ana e organeve gjyqësore, organeve gjyqësore i referohet domethënë, termi i organeve gjyqësore i referohet strukturave domethënë paralele që kanë vepruar atje konsiderohen si të vlefshme. Domethënë, edhe marrëveshja dokumenti që e kam përpara e thekson këtë. Po e kaloj fjalën tash te zoti Sami Kurteshi, pastaj e ka fjalën zoti Hajdar Beqa. Fjala është për ministrin.

MINISTRI ABELART TAHIRI: po fillojmë tek kjo çështja rreth përbërjes etnike të tyre, unë nuk jam marrë specifikisht me secilin prej tyre me e pa a vjen nga komuniteti serbë apo boshnjak, romë, ashkalinj, mirëpo prej dëgjimit të emrave kam parë që në mesin e tyre ka edhe boshnjak, në mesin e tyre ka edhe të komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë, komuniteteve jo shumicë, pra është një përbërje nga të gjitha komunitetet që vijnë, komunitetet jo shumicë: serbë, boshnjak, ashkalinj, turq e kështu me radhë.

Ndërsa, listën e punëtorëve të zyrtarëve administrativ atë nuk e kam parë ajo është një çështje që i takon ekskluzivisht Këshillit Gjyqësor, normalisht si ministër i Drejtësisë mund të kem qasje dhe mund ta shoh, mirëpo ajo është një çështje që s'jam marrë fare me të, jam marrë me çështjen e dekretimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe këta e thashë edhe më herët do të jenë pjesë të gjitha gjykatat, prej Gjykatës Themelore deri te Gjykata Supreme. Sa i përket betimit të tyre unë edhe i mbeta borxh edhe kryetares së komisionit, ju siguroj që betimi i tyre është bërë ashtu siç është bërë edhe më herët për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që janë dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk ka pas kurrfarë dallimi.

Ndërsa, sa i përket këtyre aktgjykimeve që ju këtë pjesë që po e lexoni marrëveshjes, po ju siguroj që Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës në asnjë rrethanë nuk do të lejonte që të implementohet kurrë, që të zbatohet kurrfarë aktgjykimi që nuk është i ndërmarr nga Gjykatat e Kosovës dhe me ligjet e Kosovës, as nga këto institucione paralele, dhe as nga askush

tjetër. a të mbeta borxh naj send, për ato anën teknike sugjerimin po ta marr miqësore, kështu që orientimin...

ARBEN GASHI: Atëherë, po më pëlqen që po e merr miqësore orientimin gjeografik, të kisha këshilluar që të mos bëhet orientim politik kështu që edhe të kisha kërkuar që të kujdesesh nëse nuk e dinë ose të interesohesh nëse nuk je interesuar, a reflekton këto tri komunat e Mitrovicës së veriut dhe dy të tjerat a reflekton përbërjen etnike emërimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve administratorë të gjykatave dhe prokurorive.

MINISTRI ABELART TAHIRI: Po, ajo që është e rëndësishme unë besoj që pajtoheni të gjithë që ky është një hap tepër i rëndësishëm për funksionalizimin e gjyqësorit edhe në atë pjesë të Kosovës, në rast se nesër dikush prej atyre gjyqtarëve bie ndesh, merr vendim në shpërputhje me ligjet e Kosovës, Zyra e Prokurorit disiplinor e ka mundësi ta largojë at njeri nga sistemi, mirëpo në asnjë rrethanë më sistemi i Kosovës nuk do të zbrapset nga ajo pjesë në momentin kur do t'i largojmë gjykatat dhe prokurorët nga ajo pjesë e Kosovës, atëherë kemi heq dorë nga sovraniteti.

Prandaj, po them që është një moment tepër i rëndësishëm edhe pse ndodhi në dhjetë vjetorin e pavarësisë së Kosovës.

ALBULENA HAXHIU: S'e di a qëllimisht po i ik pyetjes për përbërjen etnike apo...

MINISTRI ABELART TAHIRI: Ata janë qytetarë të Kosovës zonja kryetare edhe janë rekrutuar në bazë të një konkursi i cili ka qenë i udhëhequr mbi...

ALBULENA HAXHIU: A mund të jetë një gjyqtar ta zëmë boshnjak?

MINISTRI ABELART TAHIRI: po, pse mos të jetë një gjyqtar boshnjak përderisa është ...

ALBULENA HAXHIU: Po në marrëveshje shkruan diçka tjetër, a mund të jetë kryetar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë shqiptar?

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Aty sot pat gjyqtarë edhe të komunitetit boshnjak, edhe të komunitetit serbë që u dekretuan kështu që ata do të jenë pjesë e sistemit edhe lëvizjet e tyre pastaj do të ndodhin ashtu siç e sheh sistemi i drejtësisë.

ALBULENA HAXHIU: Zoti Kurteshi e keni fjalën!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, për fjalën e dhënë!

Mirë se keni ardhur në raportim, unë s'po merrem me disa gjëra domethënë që tash më kanë irrituar pak ajo deklarata juaj se ka edhe komunitete tjera boshnjak me gjasë, ashkalinj, e përmende turq, në bazë të emrave.

Puna më e mirë kishte me qenë me na i dhënë qata emra e me i krahasuar me këtë listën që e kemi qitu me e pa vërtetë a ka vendos Beogradi a Kosova për këta gjyqtarë. Ajo është e mundur për juve si, mirë ne këtë do ta bëjmë. Një çështje tjetër që është konceptuale fundi i fundit emrat kanë ardhur. Ju thatë se ka boshnjak, turq, ashkalinj, atëherë domethënë pranimi i këtyre

gjyqtarëve qenkan në kundërshtim me marrëveshjen për drejtësi, sepse këtu thotë shprehimisht “njësi i Gjykatës së Apelit në Mitrovicë do të përbëhet nga pesë gjyqtarë serbë të Kosovës dhe dy gjyqtarë shqiptar”, s’mundet me pas edhe boshnjak, edhe turq edhe ashkalinj, ose është në kundërshtim me këtë marrëveshje ose diçka ka ngja.

Mirë, faleminderit ose për shembull kryetari i Gjykatës Themelore do të jetë një serbë i Kosovës nuk ka diskutim, ne këtu nuk mundemi me e diskutua a po pranojmë, Departamenti për Krime Serioze në rajonin e Mitrovicës do të përbëhet nga katër gjyqtarë serbë dhe katër gjyqtarë shqiptarë. Domethënë, këtu përjashtohet nëse është ajo që shumë e mirë që e paskeni bërë domethënë që këta gjyqtarë dhe prokurorë në të vërtetë shpërfaqen në përbërjen etnike të Kosovës dhe ajo kishte me qenë mirë.

Tash, po ju pyes megjithatë te koncepti po kthehem s’po shkoj më larg. A është qikjo marrëveshje, megjithatë pyetje e ime, e bazuar në parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Edhe cilat janë sipas juve si ministër i Drejtësisë parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës? Sa janë a, cilat janë a. Edhe qikjo marrëveshje a është e lidhur bazuar në parimet se ju si ministër i Drejtësisë duhet t’i dini parimet themelore të Kushtetutës. Faleminderit, zonja kryetare!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti Kurteshi!

A e dëshironi menjëherë, po më vjen keq për mediat që po duhet me u end sa këndeje sa andej por uroj të na mirëkuptojnë, pastaj pas ministrit fjalën e ka zoti Beqa, zoti Sherifi, zoti Sejdiu, zoti Konjufca ende s’je lajmëruar, mandej mirë. Faleminderit!

MINISTRI ABELART TAHIRI: Atëherë, po e nisi me të fundit, zoti Kurteshi sovraniteti i vendit domethënë është parim themelor, shtrirja e sovranitetit është parim themelor i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Dhe, sovraniteti është kategori dhe ...

SAMI KURTESHI: Jo, parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ...

MINISTRI ABELART TAHIRI: Ndërsa, sa i përket çështjes etnike të asaj se çfarë përbërje, unë thashë nuk e kam kërkuar listën e tyre që të shohim saktë nëse ata janë gjyqtarë që vijnë nga komuniteti turk, unë e thashë përshtypja ime nga mbiemrat e tyre dhe nga emrat që u lexuan domethënë kishte komunikuar nga të gjitha komunitetet, domethënë jo shumicë në Kosovë.

Dhe, në asnjë rrethanë domethënë këtu nuk shoh kurrfarë dëmi dhe nuk shoh kurrfarë problemi, domethënë te angazhimi i tyre në sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës. Pra, edhe njëherë po të them kjo hiqe nga mendja sepse nuk do të ketë asnjë njeri në kuadër të sistemit të drejtësisë i cili nuk do të punojë sipas parimeve që i përcakton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.

Prandaj, çdo marrëveshje që do të jetë, që ju konsideroni që është kundër kushtetuese e keni të drejtën, e keni mundësinë, që t’i referoheni Gjykatës Kushtetuese dhe nëse Gjykata Kushtetuese thotë që është në shpërputhje me Kushtetutën ju të jeni të sigurt që ajo nuk do të implementohet. Pra, ajo që është e rëndësishme ne sot vendosëm gjyqtarët e Republikës së Kosovës edhe në atë pjesë të Kosovës. Mund të largohet ndonjëri prej tyre në rast se punon në shpërputhje me këto

norma që i kemi në fuqi, mirëpo në asnjë rrethanë nuk do të largohet sistemi i Republikës që nga sot e tutje do të vendoset në atë pjesë të Kosovës.

SAMI KURTESHI: Megjithatë, këtu e kemi një marrëveshje që Republika e Kosovës do të duhej që ta zbatonte a po.

MINISTRI ABELART TAHIRI: Ajo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

SAMI KURTESHI: Unë po e them a është e obliguar Republika e Kosovës me e zbatua këtë marrëveshje.

MINISTRI ABELART TAHIRI: Republika e Kosovës është e obliguar që të respektojë atë marrëveshje që është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe kjo është një marrëveshje ...

SAMI KURTESHI: Zoti Tahiri, a është e obliguar Republika e Kosovës marrëveshjen për drejtësi me Serbinë ta zbatojë apo jo.

MINISTRI ABELART TAHIRI: Unë e thashë, ne sot e vendosëm sistemin në atë pjesë të Kosovës...

SAMI KURTESHI: A është i obliguar me e zbatua a jo?

MINISTRI ABELART TAHIRI: Ne sot zoti Kurteshi...

SAMI KURTESHI: Një çështje e kam, çështja tjetër parimet kushtetuese në Republikën e Kosovës janë: jo s'është sovraniteti, barazia, mosdiskriminimi dhe proporcionaliteti. Qitu kemi, thotë: kryetari i Gjykatës Themelore do të jetë serbë i Kosovës nga Mitrovica. Pse s'mund të jetë një ashkalij nga Mitrovica, pse s'mund të jetë një shqiptar a një boshnjak?! Ky është domethënë parimi numër një. Ose nuk diskriminohen qytetarët e Republikës në bazë të etnisë, seksit ke u e di unë çka, ose po e pranojmë si parim kushtetues që diskriminohen.

Kjo përveç asaj domethënë shkel parimet e barazisë, domethënë nuk qenkan krejt të barabartë në Mitrovicën e veriut, por serbët qenkan pak më të barabartë se të barabartë a po. A i bie kjo kësaj marrëveshje. Edhe çështja tjetër domethënë një parim i proporcionalitetit që është më i vogël, por megjithatë është po aq i rëndësishëm në mesin e këtyre 40 gjyqtarëve edhe 13 prokurorëve që i keni zgjedh 107 administratorëve realisht ju thatë se ka ashkalij e turq, shqiptar, serbë... shumë mirë shqiptarët qenkan përjashtuar domethënë...

Mirë, vetëm një çështje po dua ta sqaroj megjithatë, a është shkel parimi i mosdiskriminimit edhe barazisë me këtë marrëveshje a jo. Ky nëse është shkel është kundër Kushtetutës marrëveshja, nëse nuk është shkel është në bazë të Kushtetutës, por unë vetëm po pyes këtë mos më thoni fraza e kemi impelementuar se pak para jush këtu e kishim një udhëheqëse të një agjencioni që merret me prona edhe ajo paraqiti një pasqyrë krejt tjetër në pjesën veriore të Kosovës që zoti Gashi mos e emërtoni ashtu se rrezik, edhe unë mendoj që është rrezik, tha: na s'guxojmë me

shku as me targa me këto veturat tona me targa të Kosovës por duhet me i ndërrua, me i lut UNDP-në me na i dhënë targat e veta ne me shku atje se policia s'guxon të na përcjellë dhe s'ka.

Ju po paraqitni një pasqyrë tjetër, cila është e vërteta. A guxoni ju me shku me targa, me vetura me targa pa përcjellje domethënë si në çdo pjesë të Republikës së Kosovës apo ajo na gënjeu. Sepse, ne kishim një problem, kishim udhëheqësen e një agjensioni të Republikës së Kosovës për të cilën ne kishim rezervat tona, por tha ne nuk guxojmë tha kemi probleme duhet me e lut UNDP-në me na përcjell me targa. Tash a kemi të bëjmë me të njëjtin shtet, me të njëjtin territor për të cilin ju po flisni, apo jo apo çka është duke u bërë tash. Faleminderit!

ARBEN GASHI: Ministër, vetëm një sqarim pasi jemi qito, më fal, qikjo marrëveshje a ka afat, a zbatohet veç tash a do të zbatohet përjetësisht?

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Tash a ta merr mendja që gjykatat a kanë me qenë me afat a kanë me funksionua përjetësisht...

MINISTRI ABELART TAHIRI: Ka qenë një konkurs ku këta njerëz kanë aplikuar dhe janë bërë pjesë e këtij konkursi nuk ka qenë konkurs fiktiv, kanë qenë pjesë e këtij konkursi, janë pjesë e këtij sistemi sot dhe në çfarëdo shkelje Zyra e Prokurorit Disiplinor do t'i ... ne sot vendosëm gjyqtarët domethënë në katër komunat në veri të Kosovës a po të pëlqen termi, dhe do të vazhdojnë të punojnë, domethënë derisa të ekzistojë shteti i Kosovës, do t'i kemi edhe gjykatat. Sa i përket çështjeve se a guxojnë a s'guxojnë me shku, unë gjatë kësaj periudhe kam qenë disa herë, kam qenë edhe në kapacitet privat sepse kam familjarë që jetojnë në atë pjesë të vendit dhe nuk ka kurrfarë problemi.

Tutën s'mund t'ia heqim kurrkujt domethënë edhe tash me dal prej vendit në vend, mirëpo absolutisht nuk ka në këtë periudhën e fundit s'ka pas as incidente ndëretnike, as probleme tjera të cilat paraqesin frikë për njerëz të caktuar për të shkuar në atë pjesë të Kosovës, po të siguroj për atë.

ALBULENA HAXHIU: Fjalën e ka Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje për ministrin,

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Dhe të gjithë të pranishmit.

Fillimisht përgëzoj ministrin Tahiri për punën që është duke e bërë edhe reflektimin e tij në sistemin e drejtësisë do të thotë në kuptimin pozitiv që nga dita e parë e marrjes së mandatit, është për tu përgëzuar ministri. Është mirë që edhe ministri, por edhe kryetarja edhe anëtarët tjerë kur e ftojmë për një temë të caktuar mos të thirrmi ne dokumente nëse kemi sekrete po të thirrjmë dhe të diskutojmë në rreth asaj dokumenteve që e kemi thirr, veç pak kryetare nuk të ndërhyra as ty Arben nuk të ndërhyra, tu kisha lut me qenë më serioz në mbledhje, s'ki nevojë të më sqarosh.

Ne Albulenë, jam duke fol unë Arben, ne e kemi ftuar ministrin për marrëveshjen e drejtësisë mes dy shteteve, mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë edhe e përgëzoj ministrin për punën që është duke e bërë, por unë pajtohem me pyetjet që i bëjmë por mos të flasin veç tre vetë se ne jemi këtu të gjithë deputetë dhe jemi të barabartë, as s'ka kompetencë më shumë kryetarja veç me menaxhua, as zëvendëskryetari i parë, as i dytë, as anëtarët. Edhe ne e dimë që i kemi qëndrimet politike të ndryshme, por konsideroj që është mirë të veprojmë si komision këtu. Unë, ministri i dha sqarimet që i bënë këto pyetje tha është në harmonizim, fjalën e parë që tha, tha “është në harmonizim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të gjithë ata që pretendojnë që shkelet Kushtetuta e Kosovës nuk i ndalon, përkundrazi tha rekomandoj mund ta dërgojmë si kushtetuese nëse kemi shkel Kushtetutën edhe Kushtetuta e hedh poshtë, edhe kjo marrëveshje bie poshtë.

Ne i kemi edhe praktika të kaluara. Unë e pyes nuk dua të ndalem në këtë, por nuk është mirë me i keqpërdorë ne tash edhe pse jemi politik e dimë që jemi në fushatë, dikush është i kënaqur me rezultatet, dikush i pakënaqur, kemi fol edhe më herët për fushata, por do të ndalemi këtu. Ministri tha realisht unë pata pyetjen, por meqenëse dha përgjigje, a kanë kompetenca do të thotë Zyra e Prokurorit Disiplinor mbi këta gjyqtarë që janë zgjedh edhe prokurë e para, edhe a do të ketë të drejtë Këshilli Prokurorial edhe Këshilli Gjyqësor t'i merr masat sikur për gjithë sistemin e drejtësisë, do të thotë edhe për suspendim e shkarkim e krejt nëse ata i shkelin ligjet e Kosovës. Unë këtë marrëveshje dhe këtë veprim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht ministrit të Drejtësisë e marr si një hap përpara të shtrirjes së sovranitetit të shtetit, respektivisht sistemit unik të drejtësisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës edhe një pyetje shumë teknike që edhe kjo so për ministrin që kur thirret në këtë rast që lidhet me atë që u thirr kryetarja e komisionit me emra, derisa ka pas konkurs publik emrat janë publik edhe ata njerëz i kanë konkurrar edhe secili ka mundur të i marr ata emra, ka dikë në administratë i thotë ami sa njerëz kanë konkurrar dhe janë emra publik ata, a janë serbë, a janë shqiptarë, a janë komunitete tjera ajo është çështje tjetër, por unë për konkursin e kam veç një pyetje: a i ka përjashtuar konkursi komunitetet tjera kur është dal konkursi për rekrutimin e këtij stafi, a janë përjashtuar komunitetet tjera apo është dal konkursi decidiv ka thënë të pranojmë kaq komunitet serbë, kaq komunitet shqiptar edhe te administratorët në këtë rast a i ka përjashtuar a jo, kjo është.

Nuk kisha thënë të bëjmë politikë këtu nëse komisioni është në fillim të mandatit e duam me i shpreh ne ndjenjat tona politike është mirë pa pare, ulemi e bëjmë debat politik edhe për shumë çështje tjera mundemi t'i ngritim edhe në Parlament. Unë e përgëzoj ministrin edhe i dëshiroj suksese.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Po përmendet shumë shpesh Gjykata Kushtetuese, veç po dua të ua kujtoj edhe ministrit edhe zotit Beqa që Lëvizja “Vetëvendosje” në vitin 2013, e pat dërguar marrëveshjen e prillit, domethënë që është ratifikuar në Kuvend të Kosovës në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykata Kushtetuese ka krijuar një precedent tepër të rrezikshme, sepse në atë kohë pati thënë që Gjykata Kushtetuese nuk ka të drejtë që t'i vlerësojë kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare.

Për shkak të presioneve, në atë kohë qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare, gjykata pati refuzuar që ta trajtojë kërkesën tonë, rrjedhimisht ta trajtojë kushtetutshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare dhe tash ku të drejtohem i ne kur Gjykata Kushtetuese vetë ka kërkuar precedent

të rrezikshëm dhe vetë ka heq dorë nga kushtetutshmëria nëse më lejoni zoti ministër, vetëm tregomani një vend që funksionon, që e ka rregullimin të njëjtë sikur Republika e Kosovës që heq dorë Gjykata Kushtetuese mi ratifikua marrëveshjen, me i shqyrtua kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare. rastin konkret e kemi rastin e Shqipërisë, ku Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë shumë shpesh ka kundërshtuar marrëveshjet e ratifikuara nga Kuvendi, qoftë para, qoftë pas ratifikimit.

Domethënë, ne e kemi dërguar atje. Ju thotë që ka edhe komunitete tjera unë listën e kam në qoftë se kjo qëndron, Gjykata Themelore e Mitrovicës thotë 17, secili prej tyre janë serbë, 17 serbë. Tash unë nuk po e di a ma të vërteta janë fjalët e tua a dokumentet e shkruara.

MINISTRI ABELART TAHIRI: Ne po flasim për 40 gjyqtarë edhe 13 prokurorë, domethënë ata të gjithë unë s'e kam marrë me e pa etninë e tyre se cili çfarë etnie i takon, mirëpo unë po të tregoj që këta gjyqtarë vijnë prej komuniteteve jo shumicë, domethënë që të gjithë në mesin e tyre janë të gjitha kam përshtypjen që janë të gjitha komunitetet prej mbiemrave që unë i dëgjova sa munda me i njohur, me i identifikua.

Ndërsa, çështjen që rreth trajtimit nga Gjykata Kushtetuese ajo nuk është një çështje që unë dua të komentoj, mirëpo ju keni të drejtë që të kërkonin nëse ky proces ka qenë në përputhje me normat ligjore që janë dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Procesi i funksionalizimit të Gjykatave në veri në bashkëpunim me KGJK shikoni, kërkonin, nëse janë shkel të drejtat e njeriut, nëse nuk janë lejuar shqiptarët me konkurrue apo jo, nëse nuk janë lejuar të komuniteteve të tjera një mundësi e tillë ekziston unë besoj që KGJK-ja e ka vullnetin dhe gatishmërinë me dhënë shpjegime për këtë çështje, nuk shoh kurrfarë problemi. Po ajo çka është e rëndësishme konkursi nuk ka qenë përjashtues për askënd.

Domethënë, në rast se kjo reflekton përbërjen etnike të asaj pjese andej kjo do të thotë që nuk kanë shkuar gjyqtarë ose prokurorë nga komuniteti shumicë nga shqiptarët që të aplikojnë edhe të jenë pjesë e këtij procesi. Po jo edhe besoj që Gjykata Kushtetuese mund ta komentojë nëse ky proces është në përputhje, funksionalizimi i Gjykatave është në përputhje me gjykatat apo kemi ndërtuar sistem paralel tjetër. unë jam i bindur që është në përputhje me Kushtetutën e vendit, me sistemin që ne e kemi ndërtuar tash e gjithë këto vite që nga paslufta sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe jam i bindur që ne sot kemi bërë një hap historik tepër të rëndësishëm për sovranitetin e vendit tonë.

Kam përshtypjen prej juve po më krijohet përshtypja sikur po flasim për një vend tjetër, po flasim për një territor që është pjesë e Kosovës që s'e kemi kontrolluar mirëpo po e kontrollojmë që ne po e kontrollojmë ndërsa ne s'po e trajtojmë siç po e trajton kurrkush ne po e trajtojmë si territor të Republikës së Kosovës, atë po e bëjmë. Mua po më habit fakti domethënë trajtimin që po e shoh nga ju për atë pjesë të Kosovës që është e banuar me shumicë nga komuniteti jo shqiptar, nga komunitetet tjera.

SAMI KURTESHI: Kjo sjellje e juaj, zoti ministër, është krejt skandaloze. Ne as nuk po e trajtojmë, as nuk po e ç'trajtojmë ne veç po flasim për gjëra që i kemi në dorë fakte, dhe po flasim për qëndrime të institucioneve të Republikës së Kosovës, agjencionet që pak më parë me gjithë insistimin tonë pse bëhet ndryshimi i tabelave, pse s'mund t'i zbatoni vendimet e

Agjencionit në lidhje me pronat në veri, thotë ne kemi shumë probleme me i zbatua ato, me i realizu për arsye se as policia nuk mundet e ne duhet të shkojmë me tabelat e UNDP-së.

Ne nuk po flasim për perceptime personale, edhe kjo fjalë juaj në fund është krejt skandaloze kush po e trajton cilën pjesë po e trajton. Ju tha zoti Gashi mos e quani “pjesa veriore” andej-kënde, ... te përfundoj aspekti gjeografik edhe politik i trajtimit të pjesëve të ndryshme të Republikës së Kosovës, sepse ju jeni ata që i trajtoni ndryshe jo ne. Nëse ju e quani pjesa veriore e Kosovës ju jeni, na po themi e kemi një marrëveshje në bazë të kësaj marrëveshje, janë disa obligime a do t’i zbatojë Republika e Kosovës këto obligime, apo jo, kjo është çështja.

Kurrkush as juve s’ju sulmoj personalisht ne i kemi marrëveshjet, ne i kemi dokumentet, ne po flasim për këtë, mos flisni për trajtimin kush si po e trajton, ne po kërkojmë qëndrim zyrtar të Republikës së Kosovës a është kjo e vërtetë që po na thonë edhe agjencionet, edhe ju, edhe këto dokumente që i kemi apo jo. Edhe mos e gjuani topin diku tjetër, mos devijoni debatin, debati është a unë ju pyeta edhe s’thatë kur a e zbatoni a është e obliguar Republika e Kosovës me e zbatua këtë marrëveshje a jo.

Çka ka personale këtu, edhe ju thatë po, edhe ne thamë në qoftë se është ashtu domethënë atëherë a paskan të drejtë me ardh gjyqtarët e komuniteteve tjera, prokurorë të komuniteteve tjera, çka ka të keqe këtu. Nëse marrëveshja thotë veç shqiptarë edhe serbë, domethënë s’paskan të drejtë të tjerët. Çka ka këtu personale? Pse po përpiqeni me e gjuajt topin, kush janë ata ju që po e trajtojmë, ne jemi këtu do deputetë, thoni me emër. Ne po themi zoti ministër, këtu janë disa gjëra që ju s’po mundeni t’i shpjegoni, kjo është çështja. A mundem, të lutem.

ALBULENA HAXHIU: A ka mundësi zoti Sherifi që është...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Po unë po ju kërkoj, unë vetë kam qenë thashë edhe në kapacitetin privat unë vetë kam qenë zoti Kurtoshi edhe në kapacitetin privat edhe zyrtar në atë pjesë të Kosovës, po ju inkurajoj edhe juve se ju e gjuajtet topin diku tjetër, thatë që folët për një zyrtar që ka qenë më herët para juve shkoni dhe provojeni vetë, unë e kam provuar, me targa të Republikës së Kosovës kam qenë në atë pjesë me veturë private, jam kthye s’kam pasur kurrfarë problemi, kurrfarë telashe. Nuk kam pas kurrfarë incidenti, tash e 2-3 vite unë po të kërkoj, po të inkurajoj edhe ty, edhe të gjithë juve që jeni në sallë shihni sa është e vërtetë një gjendje e tillë, se është 40 km prej këtu apo është ashtu qysh ka thënë shëfja e agjencisë.

... por nuk është çështja ime, as e juaja...

ALBULENA HAXHIU: Unë besoj që secili diskutim që është bërë është në raport me temën që është ftuar edhe ministri, tek e fundi jeni ministër i Drejtësisë duhet të ballafaqoheni me të gjitha pyetjet e deputetëve. Zoti Sherifi!

BILALL SHERIFI: Këtu kemi një temë për të cilën e kemi ftuar ministrin në interpelancë edhe natyrisht që ka shumë gjëra, të cilat lidhen edhe historia e krejt këtij procesi na kthen pak në të kaluarën ministër, edhe sigurisht që kemi nevojë pastaj të konfirmojmë pozicionet tona që i kemi pas, i kemi apo nuk i kemi pas dhe i ndryshojmë, është e drejtë fund të fundit qëllime politike çdo kush ka të drejtë t’i ndryshojë mirë do të ishte njëherë t’i ndryshojnë faktet pastaj të ndryshojnë qëndrimin.

Unë vazhdoj të mbroj qëndrimin tim që kam pas mes Kosovës dhe Serbisë nuk ka pas marrëveshje ndërkombëtare asnjëherë. Ka pas një proces bisedimesh mes dy vendeve ku me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian dhe aktorëve të tjerë dy palët kanë rënë në dakordancë se si mund të mos e quajmë veriu i Kosovës, por ajo është aty të integrohet në kuadër të tërësisë edhe territoriale, por edhe në aspektin e sovranitetit të Kosovës. Pra, përderisa për dekada kemi pas ushtrim të sovranitetit të Serbisë përmes mekanizmave të vetë në atë pjesë të Kosovës mund të mos ta quaj në veri, por ajo është në veri të Kosovës, mund të mos e quajmë fare mos ta përdorim fjalën “veri”, por e kemi një komunë që quhet “Mitrovica e Veriut”.

Pra, duke pas parasysh krejt këtë ne s’mund t’i shmangemi kësaj terminologjie. Tash unë po ndalem te kjo që ku është gjendja sot, çka kemi sot. Nuk mund të themi ministër këtu mungon sinjeriteti, nuk mund të kemi ministër që Vuçiqi s’është duke u përzier, se dalim, dilni edhe ju, del edhe ... presidentit, del krejt Kosova qesharak, tërë ditën me muaj, me vite shkojnë në Bruksel pastaj kur vijnë këtu jo ne jemi duke e bërë Vuçiqi s’ka çka përzihet këtu.

Po, pa lejen e Vuçiqit nuk do t’i kishit këta gjykatës as pjesëmarrës në konkurs. Pra, kjo është e vërteta, ky është realiteti. Të fillojmë të komunikojmë më së pari vetë, edhe me këtë popull sinjerisht, e të mos shitemi më të fortë se jemi, as më të mençur, as mos të ditur, as më të aftë se sa që jemi. Kemi hyrë një procesi Kosova, institucionet e Kosovës kanë hyrë një procesi të integritetit të asaj pjese përmes bisedimeve, por jo përmes bisedimeve të cilat mes dy shteteve të barabarta, por mes Kosovës e cila ka shpall pavarësinë e saj dhe Serbisë e cila e konteston atë.

Pra, dalja e Serbisë përmes bisedimeve nga Kosova dhe shtrirja e institucioneve të Kosovës, a është duke u bërë kjo në mënyrën më të mirë është çështje tjetër. a është duke u bërë kjo vërtetë në harmoni me Kushtetutën është çështje që kemi pozicione të ndryshme, unë vazhdoj të mendoj që Kushtetuta po trajtohet si një thes ku shpeshherë po futen gjëra dhe me këmbë po shtypen, i nxen i nxen po thojmë. Realisht s’po i nxen, po shihet nga njerëzit që nuk po i zë. Pra, ministër marrëveshja nuk ka qenë në përputhje me Kushtetutën, nuk po të kërkoj këtu pyetje është qëndrimi im, Gjykata Kushtetuese ka heq dorë nga interpretimi i kësaj marrëveshje a është kushtetuese a jo, ... atë argument se s’është marrëveshje ndërkombëtare se në marrëveshje ndërkombëtare që ratifikohen nga dy parlamente natyrisht që çdo gjykatë kushtetuese e çdo vendi republikan parlamentar .. i trajton.

S’ka dilema aty, por për faktin se ajo nuk ka mundur ta trajtojë atë si gjykatë, si marrëveshje ndërkombëtare, tash megjithatë nuk është se jemi krejt pa mekanizma, të nderuar kolegë, ajo marrëveshje prodhon akte juridike. Ne aktet juridike mund t’i dërgojmë në Gjykatë Kushtetuese. Ato të cilat marrin formë ligjore juridike ne mund t’i dërgojmë në Gjykatë Kushtetuese pa iu referuar fare marrëveshjes, por të kërkojmë a është në përputhje tash ky akt me Kushtetutën. Unë kam kaq sa i përket pozicioneve politike, vazhdoj të qëndroj, kurrë nuk i ndryshoj qëndrimet e mija, sepse s’kanë ndryshuar faktet. Unë kam një pyetje ministër: a kanë dhënë provimin e jurisprudencës këta gjykatës dhe prokurorë edhe ku e kanë dhënë? Se besoj që gjykatësit, avokat prokuror nuk mund të bëhesh, kur e kanë dhënë, nëse gabo, nëse s’është qashtu kërkoj ndjesë, mendoj që duhet të jepet. Ku e kanë dhënë, kur e kanë dhënë? Se kjo çështja e dhënies së emrave atje Vuçiqi natyrisht që i ka dhënë Vuçiqi ata emra, mos të bëjmë hajgare. Çështja është ministër mbaj shënime, çështja është se krejt folët unë natyrisht që i ka dhënë, por ajo nuk e bën akt ligjorë atë, nuk mundesh me thënë ti e çka ke fol me Vuçiqin, çka je marrë vesh me Vuçiqin

nëse s'paske marr një letër unë i dua qita gjykatës të mi. Mendove që Vuçiqi do të jap leje që t'i integrohen gjykatësit të cilët nesër nuk do ta dëgjojnë, jo bre.

Kjo është politik, pra s'po të pyes, por po e them mendimin tim. Pyetja ime është: ku e kanë dhënë, kur e kanë dhënë. Pastaj, sa i përket aktgjykimeve të mëhershme nga strukturat të ashtuquajtura "paralele" që për mua s'kanë qenë paralele, por kanë qenë të Serbisë në Kosovë, se paralele do të ishin sikur të ishin të Kosovës dhe kontestojnë, ata kanë qenë struktura të Serbisë, pra janë paguar nga Serbia. A ka ndonjë marrëveshje këtë mund të mos ta dish nuk ke qenë pjesë e saj, por thjeshtë po të pyes ku natyrisht në bllok nuk mund të shndërrohet në aktgjykimet të Kosovës, por përmes ndonjë procesi tani nga gjykatat në komunat veriore përmes një aspekti formal ku merren aktgjykimet, trajtohen nga 10-15 në ditë dhe për ligjin edhe shndërrohen në aktgjykime, tanimë të sistemit të gjyqësorit të Republikës së Kosovës të shtrirë në atë pjesë të Kosovës.

Pra, nëse nuk e di më mirë thoni nuk e di, por nëse e dinë, nëse nuk e thua ashtu siç është nesër prapë do të shihemi, do të kapemi për fjalë kot e kot kapemi me njëri-tjetrin, pra kjo është ajo që dashta unë, këto dy pyetje edhe për aspektin e qëndrimeve politike ato nuk ke nevojë të komentosh sepse ato janë të mijat, ti i ke të tuat, unë i kam të mijat. Këto dy pyetje i pata për ju, ju faleminderit!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti Sherifi! Arben a po insiston me ia kthy.

ARBEN GASHI: E pata një replikë me zotin Sherifi veç me ia sqarua se e kam shumë të qartë kur i referohem një çështje de e di saktë çka po them. Nëse flasim për Kosovën veriore, ju i dini disa procese tash po t'i them edhe direkt që kanë ndodh në këtë vend.

Është formimi i Asociacioneve të Komunave me shumicë serbe, ju e dini se aty thuhet Kosova veriore, komunat e Kosovës veriore kanë të drejtë në polici, kanë të drejtë në gjykata, kanë të drejtë në fondin për veriu, kanë të drejtë në të hyrat doganore, kanë të drejtë në shëndetësi, kanë të drejtë në universitet e tjerë.

Pra, çka kërkoja unë që të mos bëhet terminologji e zakonshme politike, të mos na bëhet e zakonshme Kosova veriore, sepse nuk ekziston dhe nuk duhet të ekzistojë e para, e dyta të mos lejohet të bëhet rajon administrativ, sepse ka tendenca të bëhet rajon administrativ dhe e treta, të mos përdoret as si identifikim gjeografik. Pra, kisha të qartë se çka po them kështu që mendoj që ka pas një keqkuptim mes meje dhe teje se çka po i referohemi kështu që nëse unë them që e këshilloj miqësisht që të mos përdoret të paktën në zhargonin tonë ose terminologjinë tonë edhe politike edhe ligjore Kosova Veriore ka një konotacion edhe politik, edhe administrativ, edhe territorial, edhe gjeografik. Faleminderit!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Mirë po ta kaloj fjalën meqë je mazhorancë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit! zoti Gashi nuk e pata me qëllim të keq, e pata thjeshtë me e theksua at faktin që veriun e keni atje, ajo pjesë është në veri të Kosovës nuk ndryshon më shumë e pata si diskurs kur përdoret si figurë se sa për të kontestuar pajtohem plotësisht me atë që the, ne duhet të kemi kujdes nga matje... faleminderit.

ALBULENA HAXHIU: Zoti Sejdiu, fjala është për ty pastaj zoti Konjufca.

KORAB SEJDIU: Faleminderit, kryetare!

Ministër mirë se vjen, të uroj suksese në pozitën dhe shpresoj në bashkëpunim me të gjithë ne dhe organet e tjera të drejtësisë që me ia arrit qëllimet tona të përbashkëta që i kemi që besoj për një drejtësi më funksionale në këtë vend.

Çështja për të cilën po diskutojmë sot lëngon nga ajo prej çka ka lëngu i tërë procesi i bisedimeve me Serbinë e ajo është mungesa e transparencës. U pa edhe sot që na doli një dokument që në fakt nuk e kam parë, as nuk kam pas qasje në të edhe pse ju shkuat pak më thellë a unë si qytetarë po them ishte dashur me e pa se është dokument publik. Po për atë vetëm si qytetarë i thjeshtë do të duhej të kisha qasje në të në bazë të ligjit për qasje në dokumente publike, por sidoqoftë edhe më tepër se mungesa e transparencës ka lënguar nga mungesa e sinjeritetit. Unë besoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm për rrethanat që i kemi dhe do të ishte një qasje shumë më e mirë, sikur përfaqësuesit tanë të thoshin se këto janë rrethanat, këto janë koncesionet tjera që është dashur ne t'i japim për të shtrirë sovranitetin tonë, për ta shtrirë drejtësinë tonë, në këtë rast në veri. Dhe, është dashur me i përpi këto koncesione për ta arritur këtë qëllim.

Pse po e them këtë? Sepse, vazhdimisht po arrihen marrëveshje shumë të mangëta, të paqarta, të cilat po bëhen, po hartohen në këtë mënyrë me qëllimin që me ua shitë edhe popullatës në Serbi, edhe popullatës në Kosovë, edhe qytetarëve serbë të Kosovës, në versionin që po kanë dëshirë t'ua interpretojnë përfaqësuesit e tyre në këto bisedime. Aq paqartë e absurde, sa që arrijnë rezultate si neni 11 e 12 i marrëveshjes së Drejtësisë, ku thotë: “objekti i dytë i Gjykatës Themelore do të përbëhet nga departamenti”, më fal por objektet përbëhen nga armatura, tullat, betoni, nuk përbëhen nga departamente.

Do të thotë, të jemi të sinqertë me qytetarët. Çfarë mua më dhemb më së shumti është se gjyqësori ynë vërtet po fragmentohet, po ndahet. E pamë më herët personin që ishte ushtrues detyre për Agjencinë e Pronave, tash me emrin e ri që është, ku merret me një çështje specifike, pastaj e kemi tash Gjykatën Speciale, tash e kemi gjykatën që unë e cilësoj si gjykatë në veri të Kosovës. Pse po e them këtë? Sepse, përkundër nomenklaturës që përdoret, e ke një Gjykatë Themelore në Mitrovicë të veriut, ashtu qëndron, si të duash shkruaje ajo është Gjykatë Themelore në veri të Mitrovicës. Njëkohësisht, e ke edhe Gjykatën e Apelit paralele, që ka qenë në luftë, të them, juridike në kohën kur është hartuar Ligji për gjykatat për ta qartësuar faktin që është vetëm një gjykatë e apelit në Kosovë dhe në fakt, thuhet se ka juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës në Ligjin për gjykatat, neni 17, pika 1.

E tash, njëkohësisht thuhet edhe që selia e Gjykatës së Apelit është në Prishtinë. E di përgjigjen formale zyrtare që do të na japin prej Qeverisë, që thotë “jo, është njësi... nuk ka të bëjë...”, mirëpo njësitë i keni themeluar me ligj të veçantë, kur e keni themeluar njësinë ekonomike për çështje ekonomike, e kështu me radhë...

Çka po kërkoj nga ju, është sinjeritet tash e tutje. Nuk ka pasur. Të lutem, mos të krijojmë situata të tilla, ku ju duhet të vini para nesh e të mbron diçka që ndoshta edhe nuk keni pasur kompetencë totale gjatë hartimit dhe gjatë marrjes së vendimeve. Por, në anën tjetër desha të ju pyes a jeni të vetëdijshëm që me këtë marrëveshje tash duhet t'i ndryshoni edhe ligjet që janë në

fuqi, përfshirë edhe Ligjin për gjykatat, në mënyrë që të reflektohet këtu. Është në proces dhe po...

ALBULENA HAXHIU: Parëz tha që është në perputhje me ligjin, tash po thotë “ndryshimi është në proces...”

KORAB SEJDIU: OK, domethënë jeni të vetëdijshëm se ka nevojë që kjo me u zbatua në ndryshimet e radhës, që janë për Ligjin për gjykatat.

Çështja tjetër, sa për diskriminimin flamuri i Kosovës, i mirë i keq, i ka më shumë se dy yje. Kështu që, në momentin që ju e keni kufizuar pjesëmarrjen e gjyqtarëve në këtë gjykatë në vetëm dy komunitete, ju keni bërë shkelje, pavarësisht faktit a keni lejuar pjesëtarë të komuniteteve tjera të aplikojnë apo jo, sepse te çështja e diskriminimit nuk është vetëm nëse e lejoni aplikimin, është edhe efekti. Do të thotë, ju mund të lejoni këdo të aplikojë, por nëse ju vazhdimisht përzgjidhni këto dy komunitete është çështje diskriminuese që është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Prapë e di përgjigjen që do të ma jepni, “shko në Gjykatë Kushtetuese”, por e dimë si e kemi Gjykatën Kushtetuese dhe çfarë vendimesh merr kur janë çështje të ndjeshme politike dhe se si vazhdimisht, ose i eskivon ato, ose i merr vendimet që na lënë në “fushë të minuar”.

Një pyetje që e kam është, sa i përket betimit që është dhënë sot, sepse besoj se të gjitha koncesionet që i bëjmë, qoftë nëpërmes kësaj apo diçka tjetër, është që të shtrijmë sovranitetin tonë dhe të kemi gjyqtarë dhe prokurorë të bindur ndaj sistemit tonë të drejtësisë dhe sistemit tonë kushtetues. A kanë dhënë betim ata sot para presidentit? Se, Albulena një herë e kaloi këtë të parën, shkoi te ajo “betimi a është kështu a është në përputhje”, a kanë dhënë betim dhe a mund të depononi te ky komision incizim të procedurës së dhënies së betimit, që ne ta vlerësojmë, jo sipas fjalëve tuaja, po të jemi dëshmitarë të dorës së parë të betimit të dhënë nga këta gjyqtarë.

ALBULENA HAXHIU: Ka pasur medie, më fal, a keni qenë? E pse për gjyqtarë të tjerë ka medie e për gjyqtarë... Zoti Sejdiu, a...

(Debat në sallë.)

KORAB SEJDIU : Kam pyetje, veç desha këtë një herë, a mund të na e depononi incizim të dhënies së betimit, ku ata e çojnë dorën e thonë “Betohem!”?

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Unë ju siguroj që sot ata e kanë kryer procesin e betimit.

ALBULENA HAXHIU: A bën veç pak. ... me mikrofon, pastaj kur ta përfundon kthehemi te zoti Konjufca, në qoftë se zoti Sejdiu...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: A vazhdojmë me përgjigje, të lutem?

ALBULENA HAXHIU: Vazhdo me përgjigjen për zotin Sherifi, besoj që ke mbajt shënime. Pastaj zoti Sejdiu, në qoftë se ka tjerë...

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Sa i përket provimit të jurisprudencës, i nderuar zoti Sherifi, domethënë këto janë kriteret që i ka përcaktuar Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, mirëpo nuk mund të jetë gjykatës në asnjë rrethanë në Republikën e Kosovës, pa e përfunduar provimin e jurisprudencës. Dhe unë po të them, se ata e kanë përfunduar, ose ku e kanë përfunduar, është një çështje që nuk e di se ku e kanë përfunduar, mirëpo në bazë të moshës që unë i pash aty, ata me siguri se duhet ta kenë përfunduar diku prej vitit '85, ndoshta '90 a në atë kohë, sepse shumica e tyre ishin të vjetër dhe konsideroj që shumica e tyre duhet ta kenë përfunduar shumë më herët.

Jo, unë nuk besoj, aty shtroja pyetjen Këshillit Gjyqësor të Kosovës si deputet, nuk besoj që një lëshim të tillë e ka bërë Këshilli Gjyqësor i Kosovës të pranojë njerëz të jenë gjyqtarë në sistem të kësaj republike, pa e pasur provimin e jurisprudencës. Jam i bindur që një gjë e tillë nuk ka ndodhur, mirëpo për të pasur siguri të plotë, drejtoju me një pyetje Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Po mirë unë po të tregoj, unë do ta marr edhe përsipër dhe do të drejtohem, jo unë do të kërkoj, mirëpo të jeni të bindur se nuk mundesh me qenë gjyqtar dhe prokuror në Republikën e Kosovës pa e pasur të përfunduar provimin e jurisprudencës.

BILALL SHERIFI : Kryetare, më fal, unë thash kur, ku,...

BILALL SHERIFI : A ka ndonjë të futur kështu ilegalisht apo shpejt e shpejt, as s'po them ilegalisht tre ditët e fundit katër ditët e fundit, unë po dua me i ditë këto. Mbetesh i obliguar të na njoftosh ... cilësinë e deputetit të komisionit me na i dhënë sqarimet e mëtutjeshme. Kaq.

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Nëse sa i përket për ligje, që the, të rasteve, në rast se ka ndodhur diçka e tillë, unë nuk jam në dijeni që mund të ndodh një proces i tillë, që të futet në atë formë, ta quajmë, ilegalisht ose siç e the ti, përligjen rastet të futen në sistem tani. Mirëpo, të jeni të bindur se nuk do të ketë asnjë aktgjykim që s'është bërë mbi bazën e këtyre ligjeve, që janë aktualisht në fuqi. Domethënë, unë nuk jam në dijeni për ndonjë marrëveshje të tillë, e cila thotë një gjë të tillë.

Ndërsa, sa i përket çështjes së... ne kemi filluar rishikimin e sektorit të Drejtësisë, kemi hasur në shumë probleme dhe në shumë telashe përbrenda institucioneve, qoftë përbrenda gjyqësorit edhe të Prokurorisë, ku bien ndesh njëra me tjetrën. Edhe çfarëdo parregullsie, ose çfarëdo dualizmi që të kemi brenda këtij sistemi, unë jam shumë i bindur që pas dy javësh do të fillojë punën ky komision ndërinstitutional dhe këto çështje do të adresohen në rast se duhet të bëhet ndonjë ndryshim në kuadër të përmirësimit të punës së gjykatave dhe prokurorive.

Sa i përket ligjit, që thatë për gjykata, ajo është në kuadër të agjendës legjislativë të Ministrisë së Drejtësisë, Ligji për gjykatat. Është diçka që ka filluar shumë më herët, tashmë është veç në përfundim dhe besoj që në fund të këtij muaji do ta përcjell në Qeveri dhe pastaj në Kuvend.

KORAB SEJDIU: Më mbete borxh për deponimin e incizimit.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Dëgjo, ajo është... në sot kam qenë pjesëmarrës i ftuar në atë ceremoni, e organizuar nga Zyra e presidentit. Nuk jam kompetent për një gjë të tillë, por si deputet mund t'i drejtohesha, thash edhe ti mund të bësh si zoti Sherifi, prej teje po e du, po unë nuk jam kompetent me nxjerr kurrfarë materiale nga Zyra e presidentit, që nuk ndërlidhet me fushëveprimtarinë time.

Si ministër i Drejtësisë kam qenë bashkë me prokurorin e shtetit, kryetarin e Këshillit Gjyqësor, normalisht mysafir, sepse është ceremoni që organizohet nga presidenti dhe Këshillit Prokurorial, Këshillit Gjyqësor dhe prokurorin e shtetit, kemi qenë pjesëmarrës në atë ceremoni.

KORAB SEJDIU: A ke informata pse janë përjashtuar mediet vazhdimisht prej juve?

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Nuk janë përjashtuar mediet, vazhdimisht kanë qenë edhe më herët, domethënë këto kanë qenë vetëm si foto lajme të prezantuara nga Zyra e presidentit.

KORAB SEJDIU : Po, foto lajm po e kuptoj, po edhe çështja...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Në rastet e gjykuara të thash, unë e thash, bëja Bilallit, nuk ka komision. Unë çdo gjykim, çdo aktvendim i këtyre gjykatave do të jetë i bazuar në ligjet e Kosovës. Në nëse arrijmë me nxjerr diçka do t'ia drejtojmë Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor e ka për obligim me i largua ata njerëz prej pune. Domethënë, ata veprojnë në kuadër të këtij sistemi.

_____ : Edhe një çështje,

ARBEN GASHI: A ka me u formua një komision, që ka me i mbikëqyr këta...

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Në cilat raste?

ARBEN GASHI: këtyre gjyqësorëve, që janë marrë nga institucionet

MINISTRI ABELARD TAHIRI : nuk jam në dijeni...

ALBULENA HAXHIU: Më mirë thuaj nuk jam në dijeni sepse marrëveshja thote diçka tjetër kështu që...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Mirë, unë s'dua t'i komentoj, unë absolutisht kam informacione dhe ato informacione që kam po ua jap. Këta... nuk e di çka ke bërë ti me atë dokument. Nuk dua të merrem me atë dokument.

ALBULENA HAXHIU : A të ... përgjegjësi, me dhënë dorëheqje, në qoftë se qiky dokument...

MINISTRI ABELARD TAHIRI : unë jap përgjegjësi atë ditë edhe jap dorëheqje atë ditë, që puna ime bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

ALBULENA HAXHIU: Jo, unë po të them se ti po thua që qiky dokument s'di çka ke bo ti me to, unë këtë e kam marrë prej Këshillit Gjyqësor në mënyrë jozyrtare, sepse nuk është guxuar nga ata, se s'na kanë informuar, unë në Këshill Gjyqësor me e marr dokumentin s'mund të hyj. Unë kam kërkuar dokument në letër dhe tash pyetja ime është, në qoftë se qiky dokument është i vërtetuar, domethënë qëndron, a jeni në gjendje si ministër i Drejtësisë me dhënë dorëheqje për faktin se ky është dokument skandaloz.

MINISTRI ABELARD TAHIRI : unë jap dorëheqje në atë moment që puna ime bie ndesh me Kushtetutën e vendit dhe me ligjet në fuqi.

ALBULENA HAXHIU: E për deklaratat e tua nuk jep llogari? Apo,....

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Normalisht, nëse deklaratat e mia bien ndesh me dhe e cenojnë sovranitetin e vendit tonë, ose kushtetutshmërinë, normalisht që jap dorëheqje.

ALBULENA HAXHIU: Zoti Sejdiu, pastaj e kalojmë te zoti Konjufca dhe kthehemi te zoti Kurteshi

KORAB SEJDIU: Unë besoj se më e drejtë është, duke pasur parasysh që pjesa dërmuese e këtyre marrëveshjeve s'janë të nënshkruara dhe ato që janë të nënshkruara janë të fshehura, e nuk besoj që ministri i ka nënshkruar, unë e kisha drejtuar pyetjen, a jeni i gatshëm me i thirr në përgjegjësi edhe politike po ndoshta edhe penale, nëse dikush ka vepruar në aso mënyre që ka validuar vendime të marra, se unë s'kam qejf as me i quajt "grykë paralele" po ato janë institucione ilegale, që kanë vepruar ilegalisht në territor të Republikës së Kosovës. A jeni ju si ministër i drejtësisë i gatshëm që me i thirr ata në përgjegjësi për veprimet potencialisht, unë po them prapë, këtë dokument nuk kemi pasur qasje në të, pavarësisht faktit që jemi deputetë, nëse është e vërtet ajo që po thotë kryetarja këtu, a do ta merrni përsipër ju këtë betejën morale dhe politike, që me i thirr në përgjegjësi personat të cilët kanë nënshkruar marrëveshje në kundërshtim me rendin Kushtetues të Republikës së Kosovës?

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Për këtë, për sa i përket kësaj, ka institucione përgjegjëse që i thërrasin në përgjegjësi, qofshin ata prokurorë, qofshin ata gjyqtarë, qoftë ai kryeministër, qoftë ai president, që duhet të thirret në përgjegjësi për çfarëdo vepre që ka bërë, që bie ndesh me Kushtetutën dhe me ligjet e vendit. Nuk jam unë ministër i Drejtësisë as... jam ministër i Drejtësisë por s'jam, as shef i prokurorëve, as i gjyqtarëve, domethënë as i sistemit në tërësi. Jam përgjegjës për prodhimin e legjislacionit dhe politikave që ndërliken ekskluzivisht me drejtësi dhe nuk pretendoj të dal përtej kësaj çështjeje.

Marrëveshjet të cilat e tejkalojnë fushëveprimin tim nuk dua t'i komentoj, marrëveshjet që nuk kanë të bëjnë me mua si ministër nuk dua t'i komentoj. Po, çka dua është që këto grykë të funksionojnë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Ai sistem në katër komuna veriore të Republikës së Kosovës të funksionojë në përputhje me Kushtetutën e vendit. Ato aktvendime që nxirren të jenë në përputhje të plotë me ligjet e Kosovës. Kurrkënd s'do ta thërras në përgjegjësi.

ALBULENA HAXHIU: Rendin tani e ke ti... Unë rendin jam duke e ndjek, kështu që replikat janë të lejueshme. Zoti Konjufca, fjala është për ty.

GLAUK KONJUFCA: Ministër, nuk po të them faleminderit që ke ardhur, se ti pastaj duhet të thuash “Faleminderit që më keni thirrur...” e pastaj mos po përfundojmë duke thënë “Faleminderit që po më falënderon”, kështu që... tek e fundit, jemi duke i kryer detyrat tona që i kemi këtu.

Tash, unë konsideroj që lajmi kryesor i ditës është që po ekzistua një dokument i Republikës së Kosovës, të cilin dikush paska pasur interes ta mbajë fshehur! Kjo është esenca. Më e rëndësishme është përmbajtja e atij dokumenti, të cilin dikush prej politikës ka bërë shumë tryzni që ky mos të jetë pjesë e opinionit publik. E na deputetët jemi për atë, jemi për ta zbuluar të vërtetën dhe duhet t’i qëndrojmë së vërtetës deri në fund. Edhe përgjegjësia publike nuk është, ministër, veç a e keni shkelur sovranitetin apo nuk e keni shkelur, po edhe a po e thoni të vërtetën apo jo, ose çfarë lloj qëndrimesh po mbron? A po mbron qëndrime të vërteta a të pavërteta? Kjo tek e fundit, është edhe definicioni i përgjegjësisë publike të zyrtarit të Republikës së Kosovës.

Tash, kryetarja e Komisionit për Legjislacion, njërit prej komisioneve më të rëndësishëm të Kuvendit të Kosovës, e ka siguruar një dokument. Ky dokument qenka aneks i marrëveshjes së drejtësisë të vitit 2015 e arritur në negociatat e Brukselit, pra në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ky aneks qenka edhe më shqetësues se sa përmbajtja e marrëveshjes, se përmbajtja e marrëveshjes po që po se është problematike, në kuptimin e sistemit se si rregullohet sistemi gjyqësor i Kosovës, edhe ka konsekuenca edhe kushtetuese, juridiko-kushtetuese sa i përket konceptit se si e kemi ne të rregulluar sistemin gjyqësor, sepse aty në Kushtetutë përshkruan që sistemi gjyqësor i yni është unik, i rregulluar në mënyrë unike. Kjo “unik” mund të shkaktojë probleme si koncept, sepse më mirë do të ishte “unitar” të thuhet, sepse po do me thënë që është kompakt, është një dhe i vetëm. Nuk ka dy sisteme gjyqësore te ne, ka një. Me këtë do me thënë që bazamenti i aktgjykimeve është njëburimor, nuk është shumëburimor, është një burimor, kështu do të duhej të ishte, e ka një bazë universale në krejt Republikën e Kosovës.

Tash, aty dokumenti të cilin e ka siguruar kryetarja dhe që është dokument zyrtar i Republikës së Kosovës po tregon që njihen aktgjykimet e institucioneve ilegale të gjyqësorit në Kosovë. Ky është një problem shumë i madh. Pyetja të cilës nuk i dhamë përgjigje në këtë mbledhje të komisionit është, a është ky dokument i vërtetë dhe nëse është i vërtetë a njihen aktet e gjykatave të cilat kanë funksionuar në formë të institucioneve ilegale, të cilat ju po thoni edhe vet që kishte qenë mirë të shuhen, të zhduken, në kuptimin e veprimtarisë së tyre. Po nëse ato zhduken, a njihet puna e tyre? Që po e zëmë si të mirëqenë deklaratën tënde. Po themi, ata e bënë betimin te presidenti edhe u krye kjo puna e institucioneve ilegale, a njihet puna e tyre? Nëse njihet puna e tyre, nëse njihen ato akte që ata i kanë nxjerrë, kjo s’do të thotë që po shuhet veprimtaria ilegale e tyre, kjo po thotë që ka vazhdimësi, kjo është më keq se Rezoluta 1244. Më falni, në Rezolutën 1244 edhe me Kushtetutën e Kosovës, edhe me krejt korpusin legjislativ që e ka Republika e Kosovës, edhe me Kodin Penal, edhe me krejt, këtu dihet deri kur është vazhdimësia. Deri në cilin moment paraqet vazhdimësi me sistemin e kaluar? Por, me njohtë vazhdimësinë prej qershorit të vitit 1999 deri kur është nënshkruar kjo marrëveshje e drejtësisë e institucioneve të Serbisë në Kosovë, kjo është e paprecedent. Kjo nuk mund të jetë në përputhje me Republikën e Kosovës, me sistemin juridiko-kushtetues të Republikës së Kosovës, kjo është cenim i këtij sistemi.

Tash këtu dalin edhe disa probleme tjera, për shembull, pavarësia e gjyqësorit. Pavarësia e gjyqësorit është cenuar rëndë. Pse? Sepse, në Kushtetutë aty është njëfarë rregulli shumë preciz i procedurave kush i cakton, kush i emëron gjyqtarët dhe prokurorët. Tash, nëse këto po i emëruaka politika edhe negociatat me Serbinë, po del krejt jashtë rendit tonë juridik dhe institucioneve të cilat janë me Kushtetutë të thirrura për ta bërë emërimin e prokurorëve dhe të gjyqtarëve.

Atëherë, ne futemi në një problem tash tjetër edhe shumë të rëndë, sa i përket republikës sonë, qysh po funksionuaka, sepse këtu po cenohen shumë aspekte, cenohet sovraniteti shtetëror dhe sistemi unik juridik, e kemi cenimin e së drejtës së barazisë së qytetarëve “me konkurren” që po thua ti, edhe të barazisë edhe për sa i përket aspektit etnik. A jemi ne të gjithë qytetarë të barabartë të Kosovës, a kemi të gjithë të drejtë të jemi të denjë për vendet e punës në mënyrë të barabartë? Këto po i caktuaka krejt tjetërkush! Këto jo veç që po caktuaka tjetërkush edhe po caktuaka politikat, por po i caktuaka edhe në bazë të prejardhjes, çfarë e ke ti nacionalitetin. Këto janë tema shumë serioze dhe këto janë arsyeja pse ju kemi ftuar sot.

Pretendimi është ky që me i dhënë fund edhe po e përmbyll, pretendimi është ky, marrëveshja për drejtësinë është mbajtur e fshehur përnda thelbi i vet, sepse politika e paska mbajtur të fshehur aneksin e saj më të rëndësishëm. Kjo marrëveshje e paska një aneks, i cili po thotë që “këtu emrat janë të dhënë paraprakisht”. Këshilli Gjyqësor i Kosovës çka qenka? Këshilli Gjyqësor i Kosovës qenka për t’i çuar duart për atë që ka vendosur një politikan. Këshilli Gjyqësor qenka për t’i çuar duart për politikën aty! A është ky sistemi ynë gjyqësor? Nuk do të duhej të ishte kështu.

Dhe, ju si ministër i Drejtësisë që duhet të merreshit me këto çështje e keni përgjegjësinë e drejtpërdrejtë, por varet a e doni më shumë të vërtetën, a e doni më shumë presidentin, kjo është çështja kryesore, esenciale që po e diskutojmë. Nëse jeni ministër i Republikës së Kosovës dhe e doni më shumë të vërtetën, duhet ta verifikoni dokumentin, nëse është i vërtetë duhet ta bëni publike çështjen, duhet ta bëni publike për qytetarët e Kosovës. Ju jeni këtu për të ju shërbyer qytetarëve.

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Faleminderit! Sa i përket rekrutimit të gjyqtarëve, po e them edhe një herë, kam qenë afër këtij procesi në Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial të Kosovës. Nuk kemi të bëjmë me kurrfarë emërimi, as nga politika, as nga kryeministri, as nga presidenti, as nga askush tjetër. Ata njerëz që sot janë pjesë e sistemit, nuk e di se ku kanë punuar para 20 vjetësh, ose para 15 vjetësh, ose 30 vjetësh. Ata janë qytetarë të Republikës së Kosovës, shtetas të Republikës së Kosovës dhe asnjë qytetari të Republikës së Kosovës, zoti Konjufca, nuk mund t’ia mohosh të drejtën të konkurrojë në çfarëdo konkursi në Republikën e Kosovës, kur i plotëson kushtet. Kur i plotëson kushtet, pavarësisht marrëveshjes, konsideroj që ligji është mbi çfarëdo marrëveshjeje. Ky ligj i garanton çdo qytetari të Republikës së Kosovës në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Nuk pajtohem me ty kur thua, se ky është konstatim i yti politik, se politika po i vendoska, ose politika s’po i vendoska, ky ka qenë një proces që e ka udhëhequr Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës. Po flasim për gjykatat në 4 qytete të Republikës së Kosovës

dhe po flasim për gjyqtarë që janë shtet, që po fillojnë punën dhe që janë shtetas të Kosovës që kanë hyrë, që janë bërë pjesë e sistemit në bazë të këtyre rregullave që i kemi ne në fuqi.

Sa i përket këtij dokumenti që ti i referohesh nuk kam pasur të bëj me kurrfarë dokumenti, unë thjesht jam marrë me procesin se a është gjithçka në përputhje me Kushtetutën e vendit dhe me ligjet në fuqi, domethënë as nuk dua ta komentoj dokumentin, as nuk dua të komentoj çka bien deputetët tjerë. Krejt në rregull është çfarëdo çështje. Ky ka qenë procesi, edhe rekrutimi i këtyre 40 gjyqtarëve dhe 13 prokurorëve edhe i stafit administrativ, ky ka qenë një proces, ku kanë konkurruar ata qytetarë që vijnë kryesisht nga ato katër qytete të Republikës së Kosovës.

GLAUK KONUJUFCA: Dhe, pyetja ime është kështu: Çka nëse nuk është kështu?

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Po kështu është i nderuar, sepse e kam përcjellë procesin bashkë me zotin Nehat Idrizi dhe Blerim Jusufaj, që udhëheqin të dy këshillat, pra Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe këta njerëz që sot i keni pjesë të sistemit të drejtësisë kanë kaluar nëpër të gjitha procedurat që e parashohin ligjet e Kosovës. Nuk kemi kurrfarë emërimesh, nuk kemi kurrfarë involvimi të politikës, ne sot kemi funksionalizim të gjykatave në atë pjesë të Kosovës në bazë të ligjeve të Kosovës. A e kanë dashur këta njerëz para tri vjetësh Republikën e Kosovës a jo, a e kanë respektuar a jo, nuk është çështje e jona sot, as s'po dua ta diskutoj. Ata janë çështje... me rëndësi është se ne jemi të obliguar ta respektojmë, se ka shumë të tjerë që s'e duan, po jemi të obliguar me e respektua.

GLAUK KONJUFCA: Mua si ma merr mendja që funksionon përgjegjësia publike, kryetarja e komisionit po thotë: "Unë e kam një dokument..." ky dokument është i vërtet dhe ky dokument po thotë që emërimet janë bërë me ekipet negociatore, jo me konkurse. Dhe kjo po thotë, nëse kjo nuk është e saktë, atëherë unë jap llogari dhe përgjegjësi. A po e thua edhe ti të njëjtën?

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Unë po e them, që nëse ... jo, unë po e them, nëse këta njerëz, këta gjyqtarë, më fal të lutem, nëse këta gjyqtarë dhe prokurorë nuk janë rekrutuar në bazë të ligjeve që i kemi në fuqi, qysh rekrutohet, edhe në Prizren, edhe në Mitrovicë, edhe në Gjakovë, atëherë jo me mua, po komplet ata njerëz që i kanë rekrutuar, që kanë qenë pjesë e këtij sistemi në Këshill Gjyqësor dhe Këshill Prokurorial duhet të japin përgjegjësi bashkë me mua si përgjegjësi morale, si ministër i Drejtësisë.

Këtu ky proces ka qenë i udhëhequr në bazë të ligjeve të Kosovës. Këta njerëz e kanë bërë betimin sot te presidenti i Republikës së Kosovës, nuk dua të them fraza politike, por po flas për një realitet që ka ndodhur. Ky është një realitet. Çfarëdo dokumenti që ju posedoni, që konsideroni se dhunohet sovraniteti i vendit, që konsideroni se shkelet Kushtetuta, nëse konsideroni që nuk është në përputhje me ligjet tona, kemi prokurori, kemi institucione, adresoni.

ALBULENA HAXHIU: Po, vetëm pak! Zakonisht, përfaqësuesit e institucioneve kur janë përbrenda institucioneve nuk flasin karshi shkeljeve. Kështu ka ndodhur edhe me zotin Enver Hasani, kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, që në atë kohë pati hequr dorë me e shqyrtua marrëveshjen e parimeve, në ndërkohë sot edhe ai edhe zonja Mushkolaj flet. Njëjtë po ndodh edhe me zotin Fejzullah Hasani, sa ka qenë kryetar i Gjykatës Supreme asnjë fjalë s'e ka folur

për këtë proces, tash kur nuk është më kryetar i Gjykatës Supreme flet, dje hiq më larg, se te organizimi i FOL-it tha që po krijon sistem paralel me marrëveshjet aktuale.

Unë vetëm po dua ta vazhdoj aty ku e la Glauku. Te kjo marrëveshje vlefshmëria e vendimeve për pronën publike dhe çështjet e privatizimit nuk është e rregulluar me këtë marrëveshje. Domethënë, paragrafi i fundit i kësaj marrëveshjeje përjashton përveç... po

(Debat në sallë.)

Zoti Demalijaj, fjala është për ty, unë në fund e përmbledh.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Zoti ministër,

Të uroj suksese dhe punë të mbarë në detyrën e re!

Ministër, dashuria për atdhe është duke më obliguar çdo ditë e më shumë dhe jam duke u mësuar me e përgatit vetveten, me e stimulua përditë e më shumë, që kam me e dashtë këtë Kosovë, ma merr mendja, baras me të gjithë qytetarët e saj.

Duke u nisur prej këtij parimi, marrëveshjet, asnjë marrëveshje as ndërkombëtare, as e brendshme, nuk ka ndodhur pa ia dhënë vizën institucionet e Republikës së Kosovës, gjegjësisht Kuvendit, edhe për të biseduar në Bruksel. Duhet t'u qasemi problemeve seriozisht, jo hajgare, "thash" për konsum politik ditor. Kuvendi ia ka dhënë vizën dikujt për të biseduar. Kush ka qenë në pozitë edhe kush opozitë, le ta marrë përgjegjësinë.

Desha t'i qasem problemit të dytë dhe t'i bëjë dy pyetje, një opozitare dhe një të pozitës. Duke u munduar me bë tema për të dalë ne televizor e me thënë diçka, shteti nuk është duke ecur, është duke ngecur edhe bëhen pengesa dhe shumë gabim është bërë, se nuk është dashur t'ua lëmë t'i drejtojnë komisionet kryesore njerëzve që duan ta pengojnë zhvillimin e shtetit. A është Abelard Tahiri... ti s'mundesh me ma ndërpre, se jam në komision edhe kam të drejt sikur ti gjashtë sahat që fole. Edhe tjetra kështu, fillojmë me procesin e pyetjes. Nuk ka Kosova kohë më për me ndërpre. Mekanizmi më interesant është drejtësia.

Ministër pyetja opozitare, po thonë ka marrëveshje, ka ndodhë marrëveshje. Këto marrëveshje ndërkombëtare janë burim i së drejtësi, kështu duhet me bë pyetje opozita. Ti obligohesh prej marrëveshjes ndërkombëtare. A je i gatshëm me e ratifikua në Kuvend a jo, varet prej nesh, jo me të lodh shtatë sahat e "a merr ti përgjegjësinë, a jep dorëheqje..." Kjo është.

Nëse këto marrëveshje janë në kundërshtim me parimet kushtetuese edhe rregullat ligjore, a je i gatshëm me i harmonizua ti në legjislacionin e me i rehabilitu këto marrëveshje në legjislacionin dhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe këto me futë në sistemin tonë të drejtësisë, nëse janë në kundërshtim me Kushtetutën.

Edhe e ke edhe pyetjen e dytë pozitare, tash pozitë, a je i gatshëm ministër me na i pru krejt këto letra një ditë të thërrasim edhe një herë, se pasha zotin, na pozita s'po kem qasje në Beograd, vallahi jo, për besë kurrë qaso letrash s'kam pa, mos të na çojnë edhe neve me lyp prej Beogradit, tash del "jo i kem marr në Këshill Gjyqësor...". Nëse Këshilli Gjyqësor e rren ministrin e vet, prej sot jam i shkarkuar.

GLAUK KONJUFCA: Shko, Radojçiqi t'i jep...

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Shkojmë, po shkojmë, po thojmë që këtë letër ti nuk e ki, a e ke pa. po, atë letër ti po thua "qy Vuçiqi ta ka prur". Kujt më ia bje Vuçiqi ato? Në koftë se ka marrëveshje, ka marrëveshje, ka me dalë me u bë publike edhe qare s'kanë nëse qajo marrëveshje është e ratifikuame pa e shti në mekanizma institucionale dhe në ligje të Kosovës, në burime të së drejtës direkt çdo marrëveshje ndërkombëtare ne e dimë si është burim i të drejtës edhe këtu këputet gjithçka. Këto dy pyetje i kam, ministër, mos të të lodh më shumë. Faleminderit! Isha i fundit, kështu po më lënë, janë kah më diskriminojnë si mashkull.

ALBULENA HAXHIU: Para se me akuzua këtu, është mirë me dhënë llogari, ndoshta, para Prokurorisë për gjithë mashtrimet që i ke bërë me procesin e veteranëve. Veç, për këtë do të ballafaqohemi herën tjetër, zoti Demalijaj. Me këtë do të ballafaqohemi herën tjetër.

HAJDAR BEQA : Mos e keqpërdor, mos e keqpërdor, e nderuara Haxhiu, mos e keqpërdor, mos e keqpërdor, jo, jo, mos e keqpërdor të lutem, kryetare, flas si deputet edhe si zëvendëskryetar i Komisionit, mos e keqpërdor pozitën e kryetarit të Komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Pse po reagoni kur po flitet për veteranët?

HAJDAR BEQA : Dëgjo, e kemi ministrin, kur e kryen ministri bisedojmë për çka të doni. Pse po e keqpërdorni politikisht? Jo, ju po e keqpërdorni. Ne jemi të tanë të interesuar, zoti Konjufca, jemi të interesuar me i pas këto sqarime. Po, ju kisha lutur të mos e keqpërdorni pozitën e kryetares së komisionit. Në të kundërtën, jemi gjashtë me pesë, jemi këtu pozitë dhe opozitë edhe s'muj mbahet komision pa neve. E mbajmë ne komisionin edhe pa ju. Mos e keqpërdor.

ALBULENA HAXHIU: A po e ndal...

HAJDAR BEQA : Jo, s'po e ndali edhe t'u kisha lut, kryetare, edhe këtë jo kur t'i teket dikujt me fol, ose me fol një... kryetarja sa herë të don. Nuk je këtu pyetje përgjigje ti. Kemi respekt për secilin. Une e tha edhe ministri, e tha edhe ne të gjithë po themi, këtu janë katër marrëveshje që janë inkorporu në një marrëveshje.

E tha shumë mirë zoti Demalijaj, që marrëveshja e parë kur ka qenë në këtë rast e 19 prillit, është në Parlament është ratifikuar edhe ne e dimë qysh kemi ardhur deri këtu. Ministri është ministër që e ka marrë tash detyrën. E ka nisë mirë edhe kisha kërkuar prej teje, prapë po them, tash si anëtar i komisionit, dokumentet që i siguron pavarësisht në çfarë forme, se s'është mirë një kryetare e Komisionit për Legjislacion me sigurua në mënyrë të parregullt dokumente.

KRYETARJA: S'është mirë, unë pajtohem... s'është mirë me i fsheh dokumentet prej deputetëve dhe prej qytetarëve të Republikës së Kosovës. Edhe ti ndërpreje...

HAJDAR BEQA : Të paktën është shkelje, vepër penale. Nëse në rrugë jozyrtare... Kisha kërku prej teje kryetare me na informua edhe ne si komision paraprakisht me na e dërgu atë dokument, me u mbledh përpara edhe pastaj me e ditë a kemi me diskutu a jo.

KRYETARJA: Unë jam shqetësu me procesin edhe kom kërku qasje në dokumente. Nuk më kanë ofru, e kam sjellë... tjetër.

HAJDAR BEQA : Ministër, të drejtohem ty, edhe për ty edhe për krejt të tjerët që i thërrasin, keni të drejtë me u përgjigj vetëm për atë që ju ftojnë. Faleminderit!

KRYETARJA: Domethënë, deputeti...

GLAUK KONJUFCA: ...pozita që çka e mëson ministrin.

KRYETARJA: Bravo Glauk, se ma more fjalën prej goje.

HAJDAR BEQA: Jo, jo, po ju po ndërhyti Glauk. Edhe ti po ndërhyti se...

(Debat në sallë. Nuk mund të transkribohet.)

HAJDAR BEQA : O Glauk, po as ti nuk je farë monarku këtu me ardh me fol. Nëse je i zhgënjyer me rezultate të zgjedhjeve mos eja këtu. Sillu si njeri këtu. Edhe unë di për ty Glauk.

SHKUMBIN DEMALIAJ : Gjithçkafën... i vetmi mekanizëm politik në Kosovë është Lëvizja “Vetëvendosje”, që nuk i njeh gjykatat. Përditë ty i lyp policia, përditë ju lyp prokuroria, ju s’bashkëpunoni me drejtësinë edhe e lodhët njeriun tu lyp drejtësi. Jo, mua nuk më lyp kurrkush. Urdhëro, çdo kallxim penal, gjithçka... kurrë s’keni punua në institucione dhe nuk e dini natyrën e kësaj pune.

KRYETARJA: Me pas qenë Prokuroria e pavarur ish marr me ty, me mashttrimet që i ke ba, me statusin e veteranit. Ti, zoti Demalijaj, në regjionin e Dukagjinit ke bërë mashttime për statusin e veteranit, njerëzve tu ua ke dhënë statusin e veteranit. Prokuroria ka me u marr me ty herdokurë. Për këtë e ftoj me u marr me ty.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Mos të bëhet merak, i ka marrë krejt... shqyr se o kah e pastron Prokuroria, jo fjalët e rrugëve, kujt t’i teket.

ARBEN GASHI: I nderuar ministër, jemi... po më vjen keq, por jemi pak jasht rendit të ditës. po insistoj që ta përmbledhim këtë që e kemi këtu dhe t’i sqarojmë gjërat.

Mendoj se e ke për obligim, e kanë për obligim të gjitha institucionet, që marrëveshjet të cilat janë arritur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Bruksel të dërgohen në Kuvendin e Kosovës. pra, duhet të dërgohen që të mos kemi këso rastesh, ku me dokumente të marra në mënyrë joformale të shërbehemi dhe pastaj “jo është e vërtetë, s’është i vërtet” për të mos ndodhur kjo duhet Kuvendi të jetë i përfshirë.

Elementi tjetër që është i rëndësishëm, kërkoja miqësisht dhe po të konsideroj politikisht, që këto probleme t’i zgjidhim dhe të kemi sa më shumë takime, në mënyrë që të arrijmë ta maksimalizojmë interesin e vendit. Dhe, çështja e tretë që po ashtu është shqetësuese ka të bëjë

me procedurën dhe efektet ligjore, që ka me i dhënë kjo marrëveshje. Nëse do të ishte kjo marrëveshje e zbatueshme vetëm për të filluar shtrirjen e autoritetit, do të isha shumë i lumtur, në qoftë se kjo marrëveshje do të jetë afatgjatë, atëherë është pak më problematike.

Kështu që, në këto rrethana mendoj se kemi çështje që mund të koordinohemi bashkë. Mendoj se me Kuvendin mundemi shumë gjëra t'i çojmë përpara. Besoj që ka vullnet edhe "Vetëvendosja" si opozitë, çështjet që janë në interes të vendit me i mbrojt, ato që janë interes politik pastaj është çështje tjetër. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Gashi. Fjala është për zotin Kurteshi, që sa kohë është duke e kërkuar fjalën.

SAMI KURTESHI: Megjithatë, na kanë zgjedhur deputetë e parlamentarë për të folur edhe veç në lidhje me këtë temë edhe kush del jashtë kësaj teme... unë s'i thash kurrgjë kurrkujt, jo veç unë bash s'ia ndërpreva kurrkujt fjalën, mos ia nxirrni fundin. Keni punë me kryetaren dhe me zëvendëskryetarin, jo me mua. Unë kam pyetje deputetit për çështjen dhe asgjë tjetër. më duket kurrkujt, për kurrgjë s'iu drejtova, s'di çfarë keni. Por sidoqoftë, zoti ministër, megjithatë unë e kam një shqetësim dhe shqetësimin tim po e shpreh hapur. Ky dokument, detyrë e deputetit është me siguria çdo dokument, qoftë i fshehtë, qoftë legal, qoftë ilegal, që ka të bëjë me çështje publike edhe ta bëjë publik.

Pikërisht kjo është detyra e deputetit dhe e do institucioneve tjera. nuk ka të drejtë të zbulojë asnjë dokument që prek aspektin ligjor dhe aspekti ligjor është mbrojtja e të dhënave personale, nëse mbrojtja e të dhënave personale nuk është në kundërshtim me sigurinë e vendit. Prandaj, ky dokument është siguruar në mënyrë krejt legale nga një deputet edhe le të dalë Gjykata le ta dënojë.

Tash unë e kam një fjalë tjetër, zonja kryetare, ju e keni një dokument që s'e kam parë as unë. Unë po e them sinjerisht, si deputet kam me kërkuar nga Prokuroria që ta sqarojë këtë çështje, a është ky dokument vërtet që është fshehur nga Qeveria, nga Këshilli Gjyqësor apo ju keni shpikur diçka. Po, kjo nuk mund të mbetet në këtë mënyrë. Këtu e kam unë një problem, nëse e ka fshehur Qeveria, ju zoti ministër bashkë me Këshillin Gjyqësor e të gjithë ata persona që janë në atë farë hierarkie, për besë duhet me kërkuar nga Prokuroria speciale me fillua hetimin lidhur me këtë çështje. nëse ky dokument nuk është i vërtetë, qysh po konsiderohet këtu, a e merrni në Beograd a... nuk është me rëndësi, nëse ky dokument nuk është i vërtetë, zonja kryetare ju duhet të keni punë me Prokurorinë...

KRYETARJA: Natyrisht...

SAMI KURTESHI: ... edhe me Gjykatën. Edhe, unë nuk e di pse kjo punë shkon kaq larg. Po, dikush duhet të marrë përgjegjësi. Ky vend është i njohur se i mungon veç një element ligjor dhe ai është papërgjegjësia. Ne nuk kemi problem me ligjet, ligjet i kemi të këqija, i bëjmë të mira. Ky vend vuan vetëm nga moszbatimi i ligjit dhe mbajtja fshehtë e dokumenteve deri në momentin kur ato zbulohen në mënyrë skandaloze. Dhe, kjo është një mënyrë skandaloze, nëse vërtetohet, se vërtet ky dokument është inekzistent dhe është fals. Nëse vërtetohet se është i vërtetë, pjesë e bisedimeve, pjesë e dokumenteve shtesë, për besë këtu duhet të kyçet Prokuroria

Speciale, edhe pse s'kam besim hiç në atë prokurori speciale, sepse po e dimë qysh po vepron, po unë po kërkoj që me u kyç.

SHKUMBIN DEMALIAJ : Ne a e din çka jemi kah bisedojmë? Ne jemi tu pyet për marrëveshjen për drejtësi, na jemi tu e pyet pyet tash është shfrytëzu një dokument që ne asnjëri deputet nuk e kemi, që e ka vetëm Albulena.

SAMI KURTESHI: Edhe tash po kërkoj... A pajtoheni me kërkesën time.

(Debat, zhurmë në sallë.)

KRYETARI: Bilall, a ke diçka? Në qoftë se, zoti Kurteshi e ka përfunduar, po e kaloj... dakord, zoti ministër.

MINISTRI ABELARD TAHIRI : Sa i përket rehabilitimit, siç e quajte, të këtyre marrëveshjeve në kuadër të Sistemit të Drejtësisë, ne do të përkujdesemi tash, e thash edhe më herët, që për dy javë do të fillojë një grup ndërinstitucional, rishikimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë dhe kjo bëhet me një qëllim, harmonizimin e të gjitha mekanizmave, institucioneve, ligjeve që ndërlidhen me fushën e drejtësisë.

Pa dyshim që kjo nuk mund t'i ik edhe ky proces që filloi sot, domethënë fillimi i punës së gjyqtarëve në katër komuna në veri të Kosovës. edhe kjo do të jetë pjesë e këtij rishikimit, siç do të jetë pjesë e rishikimit çfarëdo procesi tjetër, që kemi pasur dualizmi, ose kemi pasur mosimplementimi të ligjeve, siç e kemi rastin, mos të dal tash prej teme, për shembull, ok... mos të hyjm sepse hapet temë tjetër, po kemi pasur shumë ligje që kemi me hartua nga viti 2013 e këndeje dhe s'kanë hyrë në funksion asnjëherë, as të gjykatave, as të prokurorive. Prandaj ky rishikim do të na ndihmojë shumë dhe besoj që në një proces, në një periudhë një vjet ose maksimumi 16 muaj, ky komision ndërinstitucional do të dalë me rekomandime dhe unë shpresoj që do të kemi një konsensus nacional të politikës, sepse besojmë që këto rekomandime kanë me kërkuar edhe ndryshime kushtetuese. Dhe, do të fillojë një proces që nuk ka të bëjë me politikën ditore, por ka të bëjë me përmirësimin e funksionalizimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë. dikush mund të besojë, dikush mund të mos besojë në këtë, mirëpo kjo do të fillojë.

Sa i përket sjelljes se marrëveshjeve në Kuvend, që e përmende, çdo gjë që lidhet me punën time si ministër i Drejtësisë, çfarëdo marrëveshje që unë do të nënshkruaj, çfarëdo involvimi tim si ministër, normalisht ky Kuvend më ka votuar dhe në këtë Kuvend do ta sjell. Nuk i ik në asnjë rrethanë asnjë marrëveshjeje, as përgjegjësisë sime politike si ministër i Drejtësisë. do të jem përball jush në çfarëdo çështje që ju më kërkon, që ndërlidhet me fushën time që unë e bëj. Mos kërkon me bo rolin as të prokurorit as të gjyqtarit, as me qenë shef i tyre, as me e udhëheq punën e tyre, unë thjesht do të përkujdesem që ta facilitojmë punën e këtyre dy këshillave, me qëllim të përmirësimit të fuqizimit të sundimit të rendit dhe ligjit në Kosovë. Këto ishin dy pyetjet, nëse s'gabo, tuajat.

KRYETARJA: Zoti Sherifi, nëse mundesh zoti Ministër, mikrofonin.

BILALL SHERIFI: Shiko, unë po insisto në diçka që nuk jeni të detyruar të polemizoni.

Marrëveshjet ndërkombëtare nuk i bën fakti që i ke lidhur në territor ndërkombëtar, siç është Brukseli. Nuk e bën një marrëveshje ndërkombëtare fakti që ti ke shkuar në një territor ndërkombëtarë ta lidhësh marrëveshjen.

Tash, parakusht për me bë marrëveshje ndërkombëtare është që dy vende, dy shtete, dy subjekte të njohin njëri tjetrin. Nuk kemi ne me i thënë apo me e quajti diçka që nuk është e tillë vetëm për ta përligjur këtu brenda. E di që e kemi ratifikuar në Parlamentin e Kosovës si marrëveshje ndërkombëtare, por kjo në fakt ka qenë një pranim, ratifikim, i një zotimi, kanë përdorur mekanizmin e ratifikimit kot për mendimin tim. Mund të jem gabim, por në fakt ajo është pjesëmarrje e një zotimi në pajtueshmëri të dy palëve, se si me i zgjidhë kontestet në territorin e Kosovës. Kjo është këndvështrimi që unë e shoh.

Natyrisht që Kosova ka qenë territori ku është dashur të zbatohen këto marrëveshje. Natyrisht se janë marrëveshje, po s'janë marrëveshje në kuptimin e asaj si e parasheh Kushtetuta jonë, nuk janë marrëveshje të tilla sepse nuk janë të ratifikuara fare në Parlamentin e Serbisë. Pra, një marrëveshje hyn në fuqi kur ratifikohet nga dy parlamente, siç është kjo e demarkacionit, që s'po arrin të ratifikohet këtu në Parlamentin tonë, këto janë marrëveshje. Kosova ka shumë marrëveshje. Në seancën e parë apo të dytë e ratifikuam një marrëveshje ndërkombëtare që kishte të bëjë me disa fonde të IPA-së. Pra, nuk është se ne nuk e dimë se çfarë buron nga e drejta ndërkombëtare. E dimë se çka janë marrëveshjet ndërkombëtare. Këto marrëveshje nuk hyjnë në atë.

Prandaj unë po them, zoti ministër, jam shumë i sigurt që ka dakordime si kjo. Unë këto i quaj dakordime, jo marrëveshje, për mua s'janë marrëveshje, dakordime me shkrim. Pra, kemi dakordime gjentëlmënesh dhe kemi dakordime me shkrim. Kjo hyn në kuadër të dakordimeve me shkrim. Natyrisht, që Kosova është e obliguar ta zbatojë. Mundet edhe mos me e zbatua, s'ka asnjë reperkusion juridik nuk ka në rrafshin ndërkombëtar, pos që shtrohet presioni politik nga Brukseli, nga Uashingtoni apo nga ambasadat. U shtrohet presion "hej, hajde vazhdoni, zbatoni këtë...". Kështu unë i shoh këto.

Nuk është se këtu është bërë ndonjë skandal këso ka ende, jam i sigurt. Po tash, a kanë ardhur këta gjykatës, po dal te tema, a kanë dalë këta gjykatës dhe janë emëruar kështu blanko, "këta kanë me ia nisë punës"? Jo. po shihet që ka pasur një proces, jo nuk është fiktiv, fiktiv është diçka që s'ekziston bre. "Fiktion", doesn't exist.

KRYETARJA: ... i rrejshëm. Janë dukur që kinse po rekrutojnë gjyqtarë dhe prokurorë.

BILALL SHERIFI: Ngadalë, ekziston ky proces. Kemi të bëjmë me procesin... oj kryetare, a ky është modeli që po na jepni a? Mos të lutem! Prit ta kryej unë.

Pra, unë ky proces ka qenë formal ka qenë bazuar në ligj, ka qenë bazuar në procedurë, por vullneti i atyre që janë marrë vesh përmes kësaj dakordance, natyrisht që ka pasur me u zbatua, se Vuçiqi do t'i kishte tërhequr ata, s'do të konkurronin më, s'do të aplikonin më. Po i lëmë këto, se ministri nuk e ka ndërmend të thotë që është kjo, ne e dimë që është edhe mbajeni mend, ka për shumë fusha të tjera aso dakordimesh, të cilat për mua janë të gabuara, por nuk hyjnë në kuadër të marrëveshjeve. Nesër me ardhë një Qeveri me thënë "nuk i njoh", s'ka asnjë

reperkusion juridik ndërkombëtar pse nuk zbatohen sikur do të kishte për çdo marrëveshje ndërkombëtare. Këtu janë ekspertët, më mirë e dinë, unë jam politikan s'jam ekspert por pak a shumë marr vesh në këto punë. Edhe Korabi edhe Arbeni edhe shoku Sami i dinë më mirë këto. Prandaj, unë po them... këtë e pata.

Ministër, mos mbroj diçka që s'mbrohet. Pra, ka dakordime të tilla, sepse procese jotransparente parakusht i kanë këto dakordime në gjashtë vjet. Pa këso dakordimesh, qoftë me shkrim, qoftë me gojë, nuk ka procese që lëvizin, ecin përpara. Ky shtet, qysh tha kolegu, s'po i them "shoku", nga AAK-ja, Shkumbini, janë marrëveshje të së drejtës burimore. Edhe ai është jurist, e din mirë që Kosova në këto obligime e ka veç një raport, e ka me Bashkësinë Ndërkombëtare, nuk e ka me Serbinë. Nesër mundet krejt këto me i rrëzua, Serbia nuk mund ta padisë për prishje të marrëveshjeve ndërkombëtare, për shkelje të marrëveshjeve ndërkombëtare, sepse as nuk të njeh.

Pra, mos hyn, mos mbroj, sepse ka me pas... se ky proces ka qenë, si me thënë, nuk ka mundur të zhvillohet ndryshe pos në këtë mënyrë, për të ecur, për t'i lëvizur çështjet nga vendi, a janë para a mbrapa ajo mbetet pastaj çështje subjektive, dikush i sheh si kthim prapa, dikush i sheh si ecje përpara. Unë i kam dilemat e mija, por këtu nuk jam për atë, jam për këtë çështje të rendit të ditës, për të cilën më keni ftuar.

Kryetare, për fund, është e drejtë e secilit deputet, nuk ia kontestoj askujt që të sigurojë dokumente edhe në rrugë joligjore, është normale, është legjitime, nëse s'është ligjore është legjitime, por kur të hyjmë këtu, korrekte do të ishte se s'po them që je e obliguar, korrekte do të ishte së paku pesë minuta pa filluar mbledhja e Komisionit me na thënë, qe merreni të gjithë kolegë të mi deputetë... Faleminderit, shoku Arben, këtë se edhe prejardhja juaj është nga "shoku".

KRYETARJA: Se, në vend që të kundërshtohet jotransparenca e Qeverisë, ju po më thoni pse s'na e ke dërgua. Unë kam dashur ta verifikoj nga ministri i Drejtësisë, a është ky dokument i vlefshëm edhe a është dokument zyrtar. Domethënë, unë nuk kam mundur me ua ... në qoftë se, e ke për këtë... mirë, mirë, por u akuzova edhe më përpara pse s'e kam sjellë më përpara. Unë kam dashur që ministri i Drejtësisë, rrjedhimisht jo vetëm prej teje, po edhe unë po të tregoj pse. Unë kam dashur me e konfirmua, në qoftë se... ministri po duket që s'e ka parë kurrë, siç po shprehet. Mirëpo, unë e kam siguruar qysh e kam siguruar, e ju tregova edhe më përpara.

Fjalën përfundimtare e ka zoti ministër, në qoftë se nuk ka askush tjetër.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

I nderuar zoti Sherifi,

Unë nuk e mbrojta, as nuk po mbroj kurrfarë marrëveshjeje. Unë jam këtu sot për të folur për funksionalizimin e gjykatave në veri të vendit dhe unë sot po të siguroj dhe po të garantoj që ai proces ka qenë në përputhje të plotë me kushtetutshmërinë e vendit tonë. Nuk jam për të mbrojtur këtu kurrfarë marrëveshjeje as të parimeve, as atë të prillit, as këtu... unë po flas në kuadër të fushëveprimit tim dhe për atë që kam parë qe një muaj e gjysmë që jam në proces si ministër i Drejtësisë në funksionalizimin e gjykatave në veri të vendit.

Unë po të siguroj, e ke të drejtën si deputet, edhe aty të mbes borxh që t'i kërkoj më herët se a e kanë provimin e jurisprudencës a jo, edhe ato do t'i sjell të gjitha informatat, edhe ku e kanë kryer dhe në asnjë rrethanë nuk po mbroj kurrfarë marrëveshjeje.

Të jeni të sigurt që me aq sa kam parë dhe sa kam qenë i involvuar ky proces është në përputhje të plotë me ligjet e vendit dhe me Kushtetutën e Kosovës. Unë po them dhe kështu ka ndodhur.

KRYETARJA: Po thua ti, sepse shumë prej deputetëve e demantuan këtë që po thua.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Nuk e demantoj kurrkush.

KRYETARJA: E demantuan. Korabi ta lexoi Ligjin për gjykatat, unë iu referova shumë shpesh edhe Kushtetutës së Republikës, mënyrës së zgjedhjes, emërimit, shkarkimit... Domethënë, nuk qëndron. Ta zëmë, që po e përmend rastin konkret të Gjykatës së Apelit, ligji po thotë se Gjykata e Apelit është një në me seli në Prishtinë. Tash, del që është,

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Ne gjykatë tjetër s'kemi bërë.

KRYETARJA: Tash, çka nënkupton kjo? Një qytetar i Pejës, ta zëmë, detyrohet 80 kilometra me ardhë deri në Prishtinë për Gjykatën e Apelit, e qytetari serb e ka te dera Gjykatën e Apelit. A është kjo diskriminuese?

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Ani, do të mundësia edhe për të tjera. Pra, në rishikim do të shikohet kjo mundësi.

KRYETARJA: Tash, ne e dimë si qëndron e vërteta. Besoj, nuk e di çfarë profesioni keni, në qoftë se jeni jurist...

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Jo, politikolog jam.

KRYETARJA: Je politikolog, nuk domethënë të jesh jurist patjetër për me i pa shkeljet e vazhdueshme që po i bëhen edhe ligjeve, por edhe Kushtetutës, sepse edhe Kushtetuta vet e tregon se si është përbërja e gjyqësorit në Republikën e Kosovës, gjë që është në shpërputhje të plotë, e përmendëm disa herë.

Edhe një herë, unë nuk mund të jap përfundim për shkak se këtu ka qëndrime të kundërta njëra me tjetrën, sigurisht që nuk e marr atë të drejtë. Ju falënderoj dhe sigurisht se do të kemi ballafaqime të tjera politike edhe në Kuvend të Republikës. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*